




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e parë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 27.1.2015 me këtë:

R E N D P U N E

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës "Handikos" në Gjilan
- 3 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "Liria" në Gjilan
- 4 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve në Gjilan
- 5 Subvencionimi i normës së Interesit për kreditë e biznesit mikro dhe agro
- 6 Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00167-8, me sipërfaqe prej 233 m², ZK-Gjilan
- 7 Informatë rreth ndërtimeve pa leje në Komunë
- 8 Informatë për investimet kapitale në Komunë
- 9 Të ndryshme

Në punimet e seancës së parë (I) morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Mediet

Seancën e parë të KK-së për vitin 2015 e hapi kryesuesja e Kuvendit Valentinë Bunjaku Rexhepi e cila i përshëndeti anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë dhe kërkoi nga sekretaria që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Në këtë seancë ishin të pranishëm 33 anëtarë, kurse munguan: Bajram Hasani, kurse Imet Rrahmani është emëruar ministër i Shëndetësisë, zëvendësimi i të cilit ende nuk është bërë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi - edhe njëherë iu përshëndes dhe fillimisht opozitës i kërkoj falje, sepse njëkohësisht e kemi shpërndarë materialin edhe për seancë të KPF-së dhe për seancë të KK-së. Mirëpo në Kuvend janë propozuar vetëm pikët e rendit të punës të cilat janë rekomanduar nga KPF.

Unë e hapi diskutimin për rendin e punës.

Sahit Abazi- sa i përket rendit të punës, në parim pajtohem me shumicën e pikave të rendit të punës, por së pari kemi një vërejtje të pika 8 e rendit të punës për të cilën pikë nuk ka ardhur fare materiali, kurse si çështje të dytë e kemi një ashtu të quajtur spastrim politikë të Shërbimit Civil, sepse shumë shefa janë ndërruar, po ndërrohen gjithmonë me arsyetimin për riorganizim të Komunës. Ky riorganizim në pamje të parë po bëhet për arsyeje politike, sepse po vijnë militant partiak, do të thotë njerëz të cilët i njohim të gjithë se janë militantë të LDK-së. Kërkojmë informacion, sepse vetëm në raste të fundit i kemi dy drejtues të sektorëve për shkak të këtij riorganizimi e të cilët nuk do të jenë më në pozitë të tillë, kurse nga ana tjetër këta dy njerëz janë vlerësuar me maksimumin e pikëve dhe në bazë të kësaj i bie që ai person ka punuar shumë mirë edhe në këtë pushtet dhe nuk ka asnjë logjikë dhe kuptim që atij t' i ndërrohet vendi i punës. Tash kemi ardhur në atë fazën që shumë pak shefa kanë mbetur nga pushteti i kaluar e të cilët sipas këtij trendi edhe ata shumë shpejtë do të ndërrohen. Mirëpo ky është shërbim civil dhe ju vazhdimisht keni premtuar se do ta depolitizoni Administratën, nuk do të veproni politikisht në këto raste, por tash ka marrë hov të madh një ndërrim politik i njerëzve në Administratën Komunale. Çdo shef që është shkarkuar ose ndërruar vendi i punës menjëherë e keni zëvendësuar me një militant partiak.

Kjo dukuri nuk është e mirë dhe me siguri se kjo qasje është e gabuar dhe do t' i ketë pasojat e veta në funksionim të shërbimit civil, dhe ne konsiderojmë se kjo nuk është qasje e mirë, prandaj e jona është që ta sqarojmë opinionin dhe kërkojmë që të ndalet kjo dukuri.

Në anën tjetër të gjithë shefat që kanë prejardhje ka LDK-ja, unë e kam shqyrtuar dhe jam informuar se si janë trajtuar në qeverisjen e kaluar dhe jam bindur se të gjithë iu janë rrit koeficientët, trajtimi ka qenë jashtëzakonisht i mirë, nuk kanë pasur asnjëherë pengesa politike, kurse sot po ndodh diçka krejt tjetër, sepse po bëhen ndërrime dhe transferime dhe ndërrime arbitrare dhe partiake në pozita të ndryshme në shërbimin Civil të Komunës.

Gjithashtu e kemi edhe pikën 7 të rendit të punës: informatë për ndërtimet pa leje, kërkoj nga drejtori që kur të vijmë te kjo pikë të na informojë se a kanë leje apo nuk kanë ndërtuesit e disa objekteve afër Fabrikës së Bukës, sepse i kam disa informata se aty dikush ka hise 5%, kurse njëri objekt nuk ka leje fare. Te pika 7 kërkojmë që të informohemi me emër dhe mbiemër se kush është pronari dhe të jetë një përgjigje e saktë se objekti "Fitorja" ka leje apo nuk ka leje ndërtimi? Ne kërkojmë saktë për ta ditur ky objekt dhe disa të tjera kanë leje apo jo, kush është pronari etj?, sepse ka fjalë të ndryshme nëpër qytet, prandaj ne kërkojmë që të informohemi saktësisht?

Mevlyde Zejnullahu- unë propozoj që të shqyrtohet mundësia e pagesës së rrymës për Shkollën Ekonomike "Marin Barleti", sepse që nga e premtja dy shkolla nuk kanë rrymë, kurse në Shkollën e Mjekësisë mësimi nuk mbahet fare, kurse në Shkollën Ekonomike në dy paralele gjithashtu nuk është mbajtur mësimi, aty ku është i vendosur kabineti i praktikës profesionale. Unë jam informuar se drejtori

ka bërë kërkesë në drejtori të Arsimit për ta shlyer këtë borxh, por nuk është shlyer borxhi, sepse nuk ka mjete, prandaj duhet sa më parë që të gjenden mjete në shumë prej 6 mijë € për t' u zhvilluar mësimi normalisht.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- pika e 8 e rendit të punës: Informatë për investimet kapitale, nuk është rekomanduar nga KPF, sepse drejtoria përkatëse nuk na ka dorëzuar material me shkrim.

Nevzad Isufi- unë në radhë të parë nuk pajtohem me kryesuesen se kemi të bëjmë me një gabim teknik në rastin e caktimit të pikave të rendit të punës. Ne mendojmë se vazhdimisht po bëhet shkelje të Rregullores së punës së Kuvendit, ku në nenin 30 thuhet sa i përket rendit të punës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës paraprakisht konsultohet me kryetarin e Komunës, kryetarët e grupeve parlamentare, kryetarin të KPF-për caktim të rendit të punës për seancë të KK-së.

Kryesuesi i Kuvendit duhet të konsultohet me shefat e grupeve, por nëse kjo nuk është bërë është një shkelje e cila nuk mund të quhet gabim teknik. Ju ndoshta jeni konsultuar me grupin e juaj parlamentar, por nuk jeni konsultuar me ne si grup politik i LVV, por as me kryetarin e grupit kuvendar të PDK-së.

Vetë caktimi i rendit të ditës para mbajtjes së KPF-së, tregon se ju i keni paragjykuar vendimet e këtij komiteti dhe njëkohësisht i keni injoruar edhe anëtarët e këtij komiteti dhe në tërësi opozitën, sepse në njëfarë mënyre nuk jemi përfillur fare.

Gjithashtu edhe materiali i dërguar me 21 janar përsëri është jashtë afatit, por kjo nuk është hera e parë që për një ditë apo dy ka pasur mundësi të shtyhet seanca vetëm për ta respektuar rregulloren dhe ligjshmërinë. Mua më habit edhe fakti se kjo është bërë edhe me dijen e Zyrës Ligjore, sepse nëse gabojmë ne nuk do të ishte shumë gabim, por pse Zyra Ligjore e ka bërë këtë lëshim nuk e kam të qartë?

Për pikat e rendit të ditës, mendoj se shumica e pikave janë propozuar vetëm për ta shtuar volumnin, sepse shumica e këtyre pikave kanë të bëjnë me subvencione dhe të gjitha këtë këto pika ka pasur mundësi të përmbledhen në një pikë. Po ashtu ju edhe teknikisht keni bërë gabime, sepse në KPF nuk e keni rekomanduar pikën 8, kurse në rend të punës për seancë figuron pika 8; Investimet kapitale në Komunë.

Po shihet qartas se propozimet që vijnë nga opozita, ju i injoroni sa herë të dëshironi, sepse sot kemi informatën për ndërtimet pa leje të cilën informatë e kemi kërkuar para dy- tri seancave. Po ashtu edhe pika tjetër që është propozuar nga opozita po shtyhet, sepse nuk është sjell materiali i duhur, vetëm për t' i injoruar propozimet që vijnë nga opozita. Këto nuk janë shenja të mira, por ne do të dëshironim që të jetë një fillim më i mbarë gjatë këtij vitit dhe dëshirojmë që mos të bëni këso shkelje, sepse ne po jemi një shembull i keq për qytetarët. Kryetari vazhdimisht e thekson se do të jemi në zbatim të ligjit dhe askush nuk është mbi ligjin, por ne nganjëherë po e dëshmojmë se jo që jemi mbi ligjin, por jemi vetë ligji dhe kjo nuk është e mirë!

Avdyl Aliu- në seancën e kaluar e patëm dhënë një vlerësim ku e thamë se ky Kuvend është Kuvend i hajrit. I thamë i hajrit, sepse në çdo seancë hyjnë ndonjë pikë e rendit të punës e propozuar nga ne këtu.

Sot kam përsëri për të uruar diçka këtu dhe uroj dr. Jashar Jasharit, zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit për shëndetësi duke i uruar punë të mbarë. Gjithashtu e shprehu edhe një kënaqësi, sepse grupi i anëtarëve të LDK-së gjithnjë ka rritje, sepse aktualisht grupi i LDK-së i numërton 15 anëtarë, sepse në këtë grup është inkorporuar edhe Ismet Hajdini e të cilit i uroj mirëseardhje, duke shpresuar se ai do ta jep kontributin e tij në këtë grup.

Mos disiplina në pjesëmarrje në punën e organeve të Kuvendit e kam fjalën për KPF-në prodhon edhe disa debate lidhur me rendin e punës, çfarë i dëgjuam edhe prej shefave të grupeve kuvendare të LVV-së dhe PDK-së. Unë kërkoj nga ata që të marrin pjesë në punë të Kuvendit në mënyrë që mos të dalim keq para Kuvendit. Ne e kemi mbajtur mbledhjen e KPF-së, por opozita ka munguar, dikush prej fillimit, dikush e ka lëshuar mbledhjen, por KPF e ka mbajtur mbledhjen dhe ka vendosur për rend të punës të cilin e kemi sot këtu. Nëse ka ndodhur një gabim teknik, ajo është e rastit, njerëzit gabojnë dhe duhet

edhe ju të keni mirëkuptim dhe duhet të reflektoni pozitivisht. Bëhet një gabim dhe e mënjanojmë atë gabim.

Fehmi Sylejmani – unë nuk po replikoj me shefin e grupit të LDK-së, por e këshilloj që mos të na mbajë leksion, sepse e njohim mirë njëri tjetrin. Unë i kam dy propozime për rendin e ditës: qysh moti i kam propozuar dhe kryetari Haziri i cili e ka përkrah para jush dhe unë e kam propozuar që të ketë deklarime jashtë rendit të ditës dhe kërkoj që të jetë ; pyetje dhe përgjigje? Pasi që është Kuvendi i parë për këtë vit kërkoj që të futet kjo pikë; pyetje dhe përgjigje, sepse kjo është shumë racionale për drejtorët që i kemi këtu përballë nesh. Unë kërkoj që menjëherë t'i propozoni për votim këto dy pika të rendit të ditës e cila është pyetje përgjigje dhe e dyta edhe pse nuk qenka prezent drejtori i Arsimit, unë kërkoj një informatë nga drejtori i Arsimit për migrimin e nxënësve, sepse kjo dukuri ka marrë përmasa të mëdha në Komunën tonë dhe kemi shifra alarmuese për zbrazje të nxënësve nëpër shkolla, prandaj kërkoj që urgjentisht drejtori të na jep informatë sa nxënës e kanë braktisur shkollën.

Këto propozime zonja kryesuese duhet t' i hidhni në votim dhe ta shohim apo votohen apo jo?

Valentinë Bunjaku-Rexhepi – kjo është pyetje përgjigje, kjo mundësi po iu epet në fillim të seancës, sepse nuk thuhet në asnjë rregullore që të ketë pikë të veçantë pyetje përgjigje? Sa i përket informatës për migrimin, në seancën e radhës mund të silllet kjo informatë, sepse sot drejtori i Arsimit nuk është prezent në këtë seancë.

Fehmi Sylejmani- nuk është e shkruar askund që ne po bëjmë pyetje dhe përgjigje, prandaj kjo duhet të futet në normativ dhe ta kemi çdo herë. Në çastin që përfundon kjo pikë, drejtorët mund të jenë të lirë dhe nuk ka nevojë të jenë të pranishëm në seancë gjatë tërë kohës. Unë mendoj se në seancën e radhës kjo duhet të jetë pika e parë e rendit të punës.

Avdyl Aliu- e kam thënë edhe më herë, por po e përsëris dhe e lusim zotin që opinioni i tjerëve nuk bëhet realitet. Edukata dhe kultura personale nuk më lejon t' i them ato gjëra as Fehmi Sylejmanit as askujt tjetër siç e tha ai për mua.

Sahit Abazi- së pari e falënderojmë Avdylin për momente gazmore që i bërë Kuvendit

Riad Rashiti- edhe unë e kam një propozim që në seanca të Kuvendit të futet edhe një pikë e rendit të punës: falënderime, përshëndetje dhe urime të cilin urim do ta përcjell ndonjë këngë me muzikë të lehtë. Mirëpo unë e kam një vërejtje sa i përket thirrjes së seancës, sepse ne e dimë që vazhdimisht po thirremi në rregullore e cila është në fuqi për funksionim normal të KK-së dhe është mirë që këtë rregullore ta arsyetoni së paku njëherë. Ne nuk e dimë që është thirr një seancë dhe që është respektuar koha dhe afati ligjor. Është mirë ta dini se dhe seanca e jashtëzakonshme thirret 2 ditë para mbajtjes së seancës, kurse ju seancat e rregullta i thirrni 2 ditë përpara.

Te pika 8 e thatë se është bërë gabim teknik, por kjo pikë kanë kaluar 3-4 muaj e cila është fut në rend të punës, përsëri është heq pa asnjë arsyeje. Ne e dimë që është temë e ndjeshme dhe ndoshta kjo qeverisje nuk ka se çka të na informojë për investime në Komunë, por duhet të informohemi ajo që është bërë, sepse në opinion dilini me deklarata për investime, kurse para Kuvendit nuk silllet asnjë informatë.

Është mirë të na njoftoni se çka është investuar dhe cilat projekte janë realizuar. Kërkoj që kjo pikë në çdo mënyrë të silllet në seancën e ardhshme dhe të silllet materiali me kohë. Unë konsideroj se edhe mungesa e kryetarit të Komunës është një gabim teknik, sepse ne edhe në seancën e kaluar për shkak të agjendës së kryetarit është thirr një seancë e jashtëzakonshme dhe është shtyrë, por mendoj se edhe sot ka qenë desh të shtyhet dhe të përshtatet seanca me agjendë të kryetarit, sepse nuk kemi kujt t' i drejtojmë pyetje.

Së paku në mungesë të kryetarit të jetë i autorizuari i tij që të merr pjesë në Kuvend dhe t' i përgjigjet pyetjeve të cilat bëhen në Seancë. Për udhë për Buxhet dhe Financa i kemi disa pyetje, sepse ne sot i kemi disa pyetje e të cilat do t' i them shkurtimisht. Së pari po theksoj se opinioni vazhdimisht po

manipulohet dhe dezinformohet për çështje të cilat nuk ekzistojnë fare. E para ka të bëjë me Projektin e Varrezave të Dëshmorëve që është bërë temë debati nëpër medie. Ne e kemi përgatit informacionin e saktë për këtë projekt dhe kemi kërkuar dhe sot kërkoj dhe të evidentohet ky propozim i imi: që kryetari i Komunës që të kërkojë nga Njësia e Auditimit për ta bërë një vlerësim të këtij projekti. Të jetë vlerësim profesional, një vlerësim institucional i cili është përgjegjës për të vlerësuar një çështje e cila është ngritur për diskutim dhe që është dezinformuar se ky projekt është nën hetime për parregullsi për keqpërdorime. Ne i kërkojmë kryetarit të Komunës që të kërkoj nga Zyra e Auditimit që ta bëjë auditimin e këtij projekti dhe të na e sjell neve në Kuvend dhe të del para qytetarëve të Gjilanit dhe të thotë se Zyra e Prokurimit e ka konstatuar se cilat keqpërdorime janë bërë dhe jo të flitet me javë të tëra dhe të manipulohet, por të konstatohet se a është me të vërtetë nën hetime dhe a ka parregullsi?

Po ashtu e kam edhe një kërkesë për drejtorin e Financave i cili edhe pse sot nuk është prezent, por t' i përcillet atij: e para të bëhet vlerësimi se a ka thyerje buxhetore, apo nuk ka thyerje buxhetore? Unë jam bindur se Gjilani nuk ka thyerje buxhetore për 4.2 milion € ashtu siç është thënë. Kryetari i Komunës e tha se Qeveria e Kosovës e ka rrit buxhetin për Komunën e Gjilanit në vlerë prej 4.2 milion €. Unë e kam analizuar buxhetin e Kosovës, por askund nuk figuron kjo rritje buxhetore. Jo që nuk ka rritje buxhetore, por ka problem, sepse për vitin 2015 Komunës së Gjilanit iu janë zvogëluar 60% e buxhetit për investime kapitale, do të thotë iu janë ndarë vetëm 1.2 milion €. Është një ndarje buxhetore e barabartë me Komunën e Shterpcës, Leposaviqit, Graçanicës etj. Tash është një shkelje edhe më e madhe se që ka qenë deri më tash. Edhe ne pajtohemi se Gjilani ka qenë i anashkaluar, mirëpo ne në këtë qasje edhe më tepër po dëmtohem si Komunë e Gjilanit.

Gjithashtu një kërkesë e kam për drejtorin për Buxhet dhe Financa, sepse ne kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare, por vazhdon mos përgjigja e këtyre institucioneve të cilat hezitojnë dhe i fshehin informacionet të cilat e kanë obligim ligjor për t' iu përgjigj. I kemi drejtuar tri kërkesa dhe për asnjërën prej tyre nuk kemi marrë përgjigje! Ne këtë çështje më nuk do ta ngrisim në KK, por do ta ngrisim në institucione tjera përgjegjëse dhe secili person përgjegjës do të jep llogari para ligjit për shkelje ligjore, fshehje të informacioneve etj.

Fehmi Sylejmani – unë po e shfrytëzoj rastin që në pikën e parë të rendit të punës të bëjë pyetje, për të cilat kërkoj edhe përgjigje. Unë kërkoj nga disa drejtorë, sepse unë iu kam drejtuar disa drejtorëve disa pyetje, por ende nuk kam marrë përgjigje dhe nuk e di pse nuk po kthehen përgjigjet?

Unë për sot e kam këtë pyetje: kërkoj që Ligji i duhanit në Gjilan të legalizohet dhe mos të vlejë fare, sepse ky ligj nuk po përfillet fare. Vetëm për ilustrim po e përmendi dhe ndoshta është një “diskriminim” shumë restorante, shumë kafiteri me emër kanë bërë investime të mëdha për ta respektuar Ligjin për pirje të duhanit, kurse në anën tjetër kemi kafiteri të cilat fare nuk ka investuar dhe tash të gjitha palët janë të barabarta dhe në këtë mënyrë po iu hyjmë në hak atyre që kanë bërë investime. Kërkoj nga organet përkatëse që janë këtu që të marrin masa ndaj atyre që e shkelin Ligjin për pirje të duhanit ose të legalizohet.

Unë kam vërejtje jashtëzakonisht nëpër qendrat e mëdha tregtare në Gjilan, nëpër të cilat fare nuk përfillet Ligji për duhanin dhe kërkoj një seriozitet më të madh nga organet përkatëse për këtë dukuri negative.

Arben Mehmeti- nga ajo që dëgjuam deri më tash, për mua shumica janë kërkesa të paarsyeshme? Një kërkesë që e pati kryetari i grupit kuvendar të PDK-së duhet ta ketë të qartë se shërbimi civil dallon nga KK. Ne si Kuvend nuk merremi me çështje të riorganizimit të shërbimit civil, sepse kjo është përgjegjësi e ekzekutivit, gjegjësisht e kryetarit të Komunës dhe Këshillit të Drejtorëve, pavarësisht se mund të jetë ndonjë lëvizje e të cilat lëvizje janë normale në sistemet kur ndërrohen pushtetet. Kjo ka ndodhur edhe në të kaluarën, sepse kemi pasur degradime dhe lëvizje pa asnjë kriter dhe shkelje ligjore, por pushteti i bën nganjëherë disa veprime që edhe pse ka mospajtime me ligjin, nganjëherë kalojnë. Ne jemi dëshmitar të së kaluarës se çka ka ndodhur këtu, por unë mendoj se kjo qeverisje lokale është vonuar për një vit për t' i bërë këto ndryshime të cilat qenkan bërë tash. Unë nuk e di se çka ka ndodhur, por ashtu si u tha nga

shefi i PDK-së, unë mendoj se ka qenë deshtë para një vitit të bëhen këto riorganizime dhe pushteti i ri të punojë me njerëzit të cilët janë më profesional. Ne nuk jemi për ta larguar askënd nga puna nëse nuk bie në kundërshtim me ligjin, por pozita është praktikë normale e institucioneve edhe në vendet ku po jetojmë. Për mua është jo normale të politizohet kjo çështje në këtë Kuvend, sepse janë përgjegjës tjerë për këto çështje.

Ndërsa sa i përket kërkesës së z. Sylejmani nga LVV për Ligjin e duhanit është mirë të mendohet në këtë aspekt, por duhet të legalizohet edhe Ligji mbi mbrojtjen e pronës publike i cili nuk është duke u zbatuar, prandaj është mirë edhe këtë ligj ta legalizojmë, sepse ne si Kuvend pasi paskemi të drejtë për të legalizuar ligje është mirë të hyjnë me një pako të dy ligjet dhe në këtë mënyrë i kontribuojmë vendit për “mbrojtje” të pronës publike.

Bujar Nevzadi – unë deshta t’ i them Arben Mehmetit se ne nuk kemi kujt t’ i bëjmë pyetje, sepse kryetari i Komunës për 14 seanca të KPF-së, sa janë mbajtur nuk ka marrë pjesë asnjëherë. Kryetari e ka dhënë një ditë një sqarim i cili absolut nuk qëndron i cili është mirë të vijë këtu dhe të ballafaqohemi.

Përveç në KPF që nuk ka marrë pjesë, ju duhet ta shihni, por nuk i shihni se as në Kuvend nuk vjen asnjëherë ! Kaluan një vit e më tepër qeverisje, kryetari nuk ka marrë pjesë një seancë deri në fund, sepse ka agjenda tjera politike të cilat i kam thënë në komitet. Duhet kryetari familjarët e vetë t’ i shpall dëshmorë, luftëtarë etj. Unë kam qenë në komision për emërtim të rrugëve dhe shesheve, por nuk e paskemi ditur, sepse paska qenë desh që ndonjë rrugë apo sheshi t’ ia vëmë emrin e ndonjë familjari të tij. Mandej kryetari ka dal shumë keq, sepse me rastin e përkujtimit të Masakrës së Gjilanit, kryetari e ka thënë se janë 8 mijë viktima gjatë masakrës, por sipas historianëve kjo nuk qëndron, sepse deri më tash dihen 1050 njerëz të pushkatuar dhe vranë në rezistenca të ndryshme. Ne kryetarët e komunave po na u dashka për t’ i zgjedhur për familjarët e vetë.

Gjithashtu asnjëherë nuk ka ndodh që të dërgohet materiali për seancë të KK-së për pa u mbajtur KPF-ja, por kjo po ndodh në kohën e kryetarit Haziri dhe kryesueses Valentinë.

Gjithashtu kryetari në një emision të RTK-së është prononcuar për “Flakën e Janarit” dhe gjatë tërë prononcimit nuk i ka përmend dëshmorët Nuhi Berisha, Rexhep Mala, Kadri Zeka dhe vëllezërve Gërvalla për të cilët dëshmorë është themeluar “Flaka e Janarit”. Kjo është shumë keq për një kryetar të Komunës i cili flet 30 minuta në një emision dhe nuk ia përmend emrat këtyre dëshmorëve.

Kam edhe shumë pyetje, por sinqerisht nuk kam kujt t’ i bëj?

Fehmi Sylejmani- unë jam shumë i vetëdijshëm kur e përmenda Ligjin për duhan dhe është e saktë se ku duhet të zbatohet, por ajo të mbetet në thonjëza, sepse më mirë është të jetë një shprehje figurative.

Sa për të tjerat që i thotë përfaqësuesi i LDK-së janë për ta zhvendosur vëmendjen diku krejt tjetër.

Për këtë arsyeje është më mirë të merreni me përgjegjësitë dhe obligimet që i keni ju të cilat nuk po i dini dhe nuk po i kryeni se sa ta zhvendosni opinionin në diçka krejt tjetër.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me rendin e punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovet rendi i punës?

Aprovohet rendi i punës me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

Procesverbali

Zijadind Maliqi- në faqen 10 rreshti i gjashtë tërë fjalisë i ka humbur kuptimi: Për shkak të rritjes së pagave në vitin 2014, sepse mjetet për rritje të pagave nuk janë paraparë për vitin 2014 dhe tash jemi dëshmitar se për vitin 2015 ka pasur një shkurtim buxhetor sidomos te mallrat dhe shërbimet dhe të komunalit, prandaj duhet të përmirësohet dhe të jetë:

Rritja e pagave për vitin 2014 prej 25%, nuk është paraparë, për vitin 2014 ajo rritje është përfshirë në buxhetin e vitit 2015.

Ibish Ibishi – mua më ven keq prej atij që mban procesverbal, sepse duhet të koncentrohet në këto fjalimet tona, sepse një fjalë e vetme ia humb komplet kuptimin fjalisë. Unë po e shoh që ka shumë lëshime, por do të ishte mirë që procesmbajtësi në të ardhmen të ketë kujdes gjatë përpilimit të procesit.

Leonorë Bunjaku- faqe 16 ku thuhet: “shumë gjëra u thanë, por nuk po mundem ta them një fakt, prandaj duhet; “nuk po mundem pa e thënë një fakt”.

Aprovohet procesverbali me këto vërejtje, me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit

2. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Handikos” në Gjilan

Isa Agushi- unë propozoj që për pikën 2 dhe 4 të debatojmë me një pikë, sepse janë pika për të cilat bëhet fjalë për subvencione dhe mjetet janë të ndara dhe pika 2 dhe 4 janë të ngjashme me njëra tjetrën.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – kush është për propozimin e z. Agushi që pika 2 dhe 4 të debatohen me një pikë?

Aprovohet propozimi i z. Agushi që pika 2 dhe 4 të debatohen me një pikë, me 26 votat e anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

Jashar Jashari- kur bëhet fjalë për subvencionim të OJQ “Hendikos” nga Komuna në kuadër të bashkëpunimit mbi subvencionim të kësaj shoqate në vlerë prej 9 mijë €, është një indikator i mirë, sepse me këtë po dëshmohet se Komuna nuk po e anashkalon këtë pjesë të shoqërisë, për socializmin e këtyre njerëzve. Unë në emër të grupit kuvendar të grupit të LDK-së e përkrahim këtë propozim për subvencionim të kësaj shoqate, në të cilën pako do të hyjnë edhe Shoqata e të Verbërve.

Sadullah Kadriu- unë e konsideroj se ky propozim është një ide dhe vendim i qëlluar dhe kërkoj nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta përkrahin këtë propozim, sepse Hendikosi është e vetmja OJQ në Komunë të Gjilanit e cila kryen edhe shërbime për qytetarët. Mirëpo unë e kam edhe një vërejtje, sepse për sa jam i njoftuar unë Hendikosi e ka bërë një projekt më voluminoz dhe do të duhej të ishte këtu në mënyrë që në të ardhmen pas 6 muajve të na e shpalos edhe pjesën tjetër të atij projekti dhe për këtë arsyeje kërkoj që ta përkrahim këtë propozim-vendim.

Selami Xhemajli- unë në emër të grupit të AAK-së i jap mbështetje, propozim-vendimit për subvencionimin e OJQ “Hendikos” dhe asaj të Verbërve. Ne edhe vitin e kaluar kemi pasur kontakte me përfaqësuesit e shoqatës dhe i kemi dhënë mbështetje dhe e përgëzoj e dhe kryetarin e Komunës i cili së paku duhet ta sigurojë funksionalitetin e shoqatës e cila luan një rol të rëndësishëm për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. Unë besoj se funksionaliteti i këtyre shoqatave do të sigurohet edhe në gjashtë mujorin e dytë me subvencionim të Komunës. Ne këtë propozim e mbështesim, por kërkojmë që marrëveshja të zbatohet me përpikëri dhe të sigurohet funksionalizmi i kësaj shoqate edhe në gjashtë mujorin e dytë të këtij vitin me një shumë më të madhe të mjeteve.

Fehmi Sylejmani- edhe ne si grup i LVV në parim i përkrahim të dy këto shoqata, mirëpo kërkojmë që funksionimi i këtyre dy shoqatave të rregullohet në harmoni me ligjin që mos të konkurrojnë me projekte, por në mënyrë ligjore të rregullohet përgjithmonë në mënyrë që mos ta votojmë çdo herë në Kuvend. Mirëpo nëse ndodh që këto shoqata subvencionohen me projekte është mirë që në material të na bashkëngjitet edhe projekti narrativ, por edhe ai financiar i kompletuar. Këto ishin disa propozime, kurse në këtë seancë e përkrahim këtë propozim –vendim.

Fatbardhë Selmani- neve na intereson të dimë, sepse nuk kemi informatë sa mjete janë marrë vitin e kaluar për OJQ “Hendikos”, por edhe nëse keni njohuri pse zotëri Remzi Kçiku deri para pak kohësh ishte drejtor i kësaj OJQ, është detyruar për ta lëshuar këtë pozitë dhe të dal jashtë Kosovës.

Ne si grup i PDK-së do ta votojmë propozimin për ndarjen e subvencioneve të Hendiksost edhe pse ky subvencionim është me një shumë të vogël të mjeteve në krahasim me nevojat dhe shërbimet të cilat i kryen për njerëzit me nevoja të veçanta. Po ashtu propozojmë që në një periudhë të afërt të shqyrtoni mundësinë e ndarjes së një shume tjetër edhe më të madhe për këtë OJQ. Mirëpo kërkoj ta di edhe pse ky propozim nuk ka ardhur në komitetin përkatës për t’u shqyrtuar, mandej për të ardhur në Kuvend.

Selvete Shurdhani- edhe unë e përkrahi këtë vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për këtë shoqatë, mirëpo edhe unë pajtohem me parafolësit se shuma pre 9 mijë €, në krahasim me shërbimet që bëhen dhe me nevojat e shoqatës është shumë e vogël, prandaj është mirë të rishqyrtohet në gjashtë mujorin e dytë në mënyrë që kjo shumë të jetë konformë me kërkesat të cilat i ka paraqitur shoqata.

Arben Mehmeti- u përkrah kjo kërkesë dhe ka qenë edhe vullneti i mirë për të ec më tutje dhe mos të kishte vërejtje në këtë drejtim dhe të thuhet ajo që e tha përfaqësuesja e PDK-së se gjëja arsyeja për mos mbështetje të kësaj OJQ ka qenë për ta lëshuar dikush vendin dhe për t’u larguar jashtë shtetit. Për mua kjo deklaratë është e palogjikshme dhe nuk ekziston asnjë arsyeje e kësaj deklarate.

Mirëpo në këtë propozim –vendim po e shoh që është një element i mirë ku thuhet duhet të përmbyllen subvencionet e vitit të mëparshëm për t’u ndarë në vitin vijues. Kjo është një praktikë e mirë, sepse është obligim ligjor i joni, pavarësisht vullnetit tonë që t’i ndajmë mjete kësaj kategorie pa asnjë arsyetim, mirëpo ligji neve si Kuvend na e kufizon atë të drejtë. Ne kemi bërë përjashtim për shkak të një vullneti të mirë si qeverisje, sepse përndryshe ka qenë deshtë të silllet një raport këtu i angazhimit dhe aktivitetit të këtyre OJQ-ve. Mirëpo ne si Kuvend ka qenë deshtë t’i shohim se cilat kanë qenë aktivitetet kryesore në mënyrë që ta kemi njëfarë baze për të diskutuar dhe ta rrisim shumën e mjeteve, por ndoshta diku edhe ta zbrisim. Po ashtu është edhe pika 4, “ mjetet financiare ndahen nga mjetet buxhetore të Komunës, kodi buxhetor i Komunës i subvencioneve përkatëse, por unë mendoj se nuk ka kod buxhetor të subvencioneve, sepse kod buxhetor ka vetëm nëpër drejtori përkatëse, por jo te subvencionet. Unë kërkoj që të shikohet mirë në mënyrë që në aspektin profesional mos të ketë probleme sa i përket legjislacionit ekonomik.

Bujar Nevzadi- mua më ven keq nga Arben Mehmeti, sepse Arbeni ka një përvojë të gjatë dhe e dinë që Remzi Kçiku që nga pas lufta është njeri me nevoja të veçanta i cili ka qenë themelues i Shoqatës “Hendikos” dhe ka punuar në këtë shoqatë, por edhe ka marrë pagë me të cilën pagë e ka mbajtur familjen. Unë kam biseduar me Remziun para se të largohet nga Kosova të cilin vitin e kaluar nuk e keni mbështet, por edhe tash është një përkrahje e vogël për këtë kategori. Arbeni e di se subvencione ka Drejtoria e Shëndetësisë, nëpërmes së cilës mund të ndahen mjete. Kjo është shumë e saktë dhe unë mund ta marrë një deklaratë nga kjo shoqatë dhe mund ta sjell këtu për ata që nuk besojnë. Unë mendoj se nuk është mirë të reagohej dhe të luhet me ndjenja të njerëzve. Kjo është arsyeja kryesore pse Remzi Kçiku ka ikur nga Kosova pas 15 viteve.

Arben Mehmeti- pajtohem me disa deklarime të Bujarit, por ne e dimë se kryetar i kësaj shoqate ka qenë një njeri politik i cili nuk ka qenë deshtë të jetë aty. Ne e dimë se këto OJQ duhet t’i ikin politizimit në mënyrë që mos të ketë pengesa për mbështetje financiare nga administratat e ndryshme, varësisht prej pushteteve. Ka qenë deshtë të kemi kujdes nga politika në mënyrë që të trajtohen njëjtë këto shoqata. Ne e dimë që Hendikos ka qenë politike, por ne e kemi mbështet sikur tash si qeverisje, por e kemi mbështet edhe në forma tjera si çështje të ushqimit, shpenzimeve të rrymës etj. Ne jemi duke i mbështetur, por këto shoqata duhet të ruhen nga politizimet, sepse i shkaktojnë dëm edhe organizatës, por edhe njerëzve të cilët punojnë aty. Ne e dimë se këta njerëz kanë qenë pjesë aktive e politikës e të cilët i kanë bërë dëm jashtëzakonisht shumë këtyre organizatave. Është ligjore se pagat nga subvencionet nuk jepen, sepse subvencionet janë për t’i mbështetur aktivitetet e këtyre shoqatave.

Riad Rashiti- unë e kam një reagim ndaj Arben Mehmetit, sepse po e dëshmon se është politizuar qeverisja aktuale dhe për qëllime politike nuk është mbështet Hendikosi deri më sot. Po shihet se Remzi Kçiku është detyruar ta lëshojë vendin e punës, të ik nga Kosova, pastaj të hyjë në rend të punës dhe t'i ndihmohet kësaj organizate. Unë i bëj pyetje Arbenit se cili institucion në Kosovë në këtë kohë është jo politik? Këtë dua ta di, nëse ka institucion jo politik, të ma thotë dikush?

Ne si PDK nuk e kemi shikuar në qeverisjen tonë se a është në PDK, LDK apo LVV? Ne e dimë që z. Kçiku një kohë ka qenë në PDK, por gjatë qeverisjes sonë ai ka dalë në LVV, por ne e kemi përkrah!

Ai ka marrë pagë, është përkrah si shoqatë dhe nuk ka pasur pasoja si individ pse e ka ndërruar subjektin politik. Ne i kemi dhënë pagë duke pasur parasysh se është njeri me nevojë të veçanta dhe është me ligj e rregulluar kjo punë dhe Komuna e ka për obligim që njerëzit me nevojë të veçanta t'i mbështesë?

Kërkesën e LVV të cilën e ka drejtuar, por edhe ne e kemi drejtuar te kryetari i Komunës për të na dhënë sqarime sa punëtorë janë punësuar me kontratë në vepër? Përgjigja është se nuk ka punëtorë të punësuar me kontratë të tillë? Mirëpo në realitet ka? Sot punësohen njerëz të politizuar dhe atë familjar, por ajo më e keqja është se 4-5 punëtorë janë nga fshati i kryetarit Llovçë, me kontratë në vepër dhe nëse dëshironi edhe emrat mund t'i lexoj, kurse nuk e ka pasur konsideratë për ta mbajtur në punë një person siç ka qenë menaxheri i Hendikosit.

Arben Mehmeti- çështja subvencioneve është çështje problematike nga e kaluara. Raportet e auditorit gjeneral, kanë konstatuar parregullsi të mëdha sa i përket ndarjes së subvencioneve. Për shkak të mos mbylljes së subvencioneve është një nga arsyet që ka pasur vonesë. Ne si Kuvend për pa e pasur një raport të Drejtorisë së Financave për mbyllje të këtyre subvencioneve të kaluara, ne normalisht nuk duhet të kemi të drejtë për të ndarë subvencione. Kjo është me ligj e rregulluar dhe këto kanë qenë ndoshta pengesa që nuk është mbështet financiarisht me mjete në konto, por për ndryshe nga Komuna është mbështet edhe vitin e kaluar me mjete financiare për projekte të caktuara dhe shpenzimeve të caktuara. Kjo nuk ka të bëjë me politikë asgjë, por ka të bëjë me çështje ligjore dhe në këtë rast kur po diskutojmë është çështje ligjore, por është vullneti i mirë i kryetarit të Komunës dhe KK-së për ta ndarë një shumë të mjeteve, pro që del obligimi që duhet të përmbillen subvencionet e kaluara.

Bujar Nevzadi- po më çudit z. Arben Mehmeti, sepse kur u ngrit çështja e ndërrimeve të shefave ai e tha edhe pse nganjëherë nuk është e drejtë ligjërisht, punët duhet të ecin përpara. Mirëpo tash ligjin po e respektojmë strikt te njerëzit me nevojë të veçanta! "Respekt" iu ka mbet te njerëzit me nevojë të veçanta ta respektoni ligjin!

Isa Agushi- unë mendoj se shuma e ndarë për OJQ "Hendikos" dhe atë të Verbërve është qesharake, është shumë e vogël. Këto janë dy shoqata të ndjeshme dhe në shoqëritë e civilizuara dhe zhvilluara shoqatat e tilla kanë shumë privilegje, kurse për mua te ne kjo shumë është tejet e vogël, mirëpo besoj se në të ardhmen besoj se kjo shumë do të rritet së paku 100%.

Arben Maliqi- unë e mora fjalën për këtë pikë të rendit të punës për të thënë se këtë çështje nuk është deshtë ta politizojmë fare! Në qoftë se edhe shkelet ligji, këto janë kategori të veçanta dhe duhet t'i ndihmojmë patjetër. Ky është subvencion dhe nuk ka nevojë për ta politizuar, sepse ata janë njerëz të cilët kanë nevojë për t'i ndihmuar. Unë mendoj se nuk duhet ta zgjasim më tepër, sepse ne kemi pasur shkelje edhe më të mëdha, kurse për këto kategori sa i përket subvencioneve nuk duhet as ta bisedojmë dhe të kemi replika.

Nevzad Isufi- edhe ne patjetër e përkrahim këtë propozim-vendim dhe u tha edhe nga kolegët se shuma me të vërtetë është simbolike! Mirëpo ne në vend se të bisedojmë se si ta rrisim këtë shumë, ne po bisedojmë diçka tjetër që nuk është temë debati. Është e dhimbshme që një anëtar i KK-së që të thotë se dikujt nuk duhet t'i takojë një ndihmë apo subvencion për shkak të përkatësisë politike, apo mendimit të

tij politik. Kjo është për keqardhje dhe vërejtje për qytetarët se nuk guxojnë të kenë mendimin e tyre politik, sidomos nëse nuk i takojnë partisë në pushtet. Duhet të insistojë kryesuesja, sepse ne po aprovojmë diçka e në të vërtetë nuk e kemi të plotësuar nenin sipas Rregullores për subvencione e që u përmend edhe nga parafolësi që lidhet me raportin. Raportet qoftë për të ardhmen, qoftë për të kaluarën në mënyrë që të plotësohet edhe në pajtim me Rregulloren për subvencione që lidhet me nenin 7 i cili sqaron mënyrën e përfitimit nga këto subvencione. Edhe unë kërkoj që kjo çështje mos të jetë si dëshirë e vullnetit tonë për t' i ndihmuar apo jo, por ta gjejmë mënyrën për t' i fut si kategori ligjore të rregullt dhe për pa pasur nevojë ata të ndihen falënderues për diçka që e kanë merituar, por mendoj se janë meritore për përfitimin e këtyre subvencioneve.

Arben Mehmeti- mirë është të përmbahemi nga deklaratat emocionale, deklaratat që janë tejkaluar¹ Ne mund ta marrim një vendim për t' i ndarë nga 100 mijë €, mirëpo kur të konstatohen shkeljet ligjore do të jemi të sulmuar pikërisht prej atyre që ndoshta sot e thonë ne e bëjmë atë ose këtë, por në realitet do të vinë ndryshe me deklarime. Kjo nuk është politike asgjë, ne i kemi mbështet edhe në të kaluarën dhe vazhdojmë t' i mbështesim edhe më tutje, por këto janë tema që njerëzit duhet të kenë kujdes dhe të ruhen nga pozicionet politike. Nuk duhet askush t' i del në mbrojtje këtyre shoqatave dhe të paraqitet këtu si ndonjë hero i këtyre organizatave. Nuk është humbje kohe për të debatuar në Kuvend, por ndoshta dikush ka nevojë të shkojë për t' i gjuajtur me gurë institucionet e Qeverisë, kurse këtu i duket se po humb kohë. Ne e njohim secilin se kush sa ka kontribuar, por mund të bëheni patriot dhe mund t' i mbështetni financiarisht e jo me buxhet të Komunës të bëhet dikush patriot. Në projektin e fundit kur ka qenë një manifestim për çështje të ndihmave sociale, banimit social e dimë të gjithë sa kemi kontribuar ne si KK dhe mendoj se nuk ka më tepër koment për të debatuar.

Nevzad Rushiti- unë dua ta relaksoj situatën, sepse nuk qe nevoja të bisedohet në këtë mënyrë, por sidomos opozita nuk duhet të merret me gjërat të cilat nuk qëndrojnë.

Subvencionet e kryetarit të Komunës ndoshta nuk janë të ligjshme, por është subvencion. Qëllimi i subvencioneve dihet se çfarë kategorie janë. Këto dy shoqata që nga pas lufta ne e dimë se si janë trajtuar? Duhet të jemi korrekt, sepse këto shoqata po trajtohen sipas mundësive që i ka buxheti komunal dhe ndihmat që janë dhënë. Është edhe e udhës që të ndihmohen këto dy shoqata edhe nga ne si anëtarë të Kuvendit dhe si familje, sepse është ndihmë e madhe, prandaj përveç si pushtet që e ndihmojmë, ne mund të jemi human dhe të bëjmë çështje humane. Unë mendoj se ky Kuvend duhet ta aprovoj këtë subvencion të cilin kryetari i Komunës e ka rekomanduar, sepse kaq ka pasur mundësi duke e ditur se këto nuk janë mjete të cilat i mbulojnë të gjitha kërkesat e kësaj kategorie. Këta kanë nevojë Qeveria t' i përkrah më tepër dhe dëshirojmë që t' i përkrah. Mirëpo si Gjilan, unë mendoj se këto dy shoqata nuk kanë mbetur keq, prandaj e jona është t' i ndihmojmë dhe nuk kemi nevojë ta politizojmë më tepër këtë çështje.

Sadullah Kadriu- kjo temë u zgjerua dhe në një mënyrë po keqpërdoret, por më duket shkak është, sepse nuk jemi duke i ditur gjërat. Personat me aftësi të kufizuara nuk kërkojnë lëmoshë dhe janë një kategori e njerëzve që llogariten 7% në Kosovë, prandaj kërkojnë vetëm barazi dhe asgjë tjetër. Mua po më habit fakti se si po thuhet, Komuna nuk ka mundësi, nuk mund ta bën dhe gjithmonë po thirremi në subvencione. Unë mendoj se në të ardhmen Komuna e Gjilanit të ketë kujdes për këtë kategori, sidomos për Hendikosin, sepse është një organizatë e cila bën shërbime për qytetarët. Kur ka mundësi Theranda t' i punësoj 2-3 punëtorë nga kjo organizatë, Dardana gjithashtu, prandaj edhe Gjilani ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë në të ardhmen.

Zijanin Maliqi- unë nuk e dëgjova askënd këtu që tha se jemi kundër subvencioneve, por të gjithë ishin për t' i ndihmuar. A janë pak apo shumë, janë këto tash për tash. Mund të bëhen edhe kërkesa tjera dhe mjetet mund të ndahen. Unë dua ta jap një sqarim dhe nuk dua ta ngacmoj askënd, sepse është respektim i ligjit kur e dimë prej nga bëhet ndarja e mjeteve. Kjo ndarje dhe ky subvencionim bëhet nga buxheti i

Komunës, por kodi buxhetor, kategori e shpenzimeve dhe subvencioneve dhe është mirë të precizohet kategoria e subvencioneve nga Zyra e Kryetarit apo drejtorive përkatëse.

Edhe një fakt tjetër duhet të mësohemi se çdo shpenzim që e bëjmë duhet ta arsyetojmë dhe kjo është e paraparë edhe në vendim- përmbylla e subvencioneve. Duhet të sillet raporti se për çfarë qëllime janë harxhuar ato mjete që janë ndarë. Kjo procedurë patjetër duhet të zbatohet dhe askush nuk është kundër ndarjes së këtyre mjeteve për këtë kategori.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për aprovim të pikës 2 dhe 4 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2 dhe 4 e rendit të punës: **2.** Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Handikos” në Gjilan **4.** Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve në Gjilan, me të gjitha vota e anëtarëve të Kuvendit, të pranishëm në punimet e seancës.

3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” në Gjilan

Valentina Bunjaku- Rexhepi-shoqata “Liria” ka kërkuar një shumë të konsiderueshme të mjeteve për t’ i ndihmuar Komuna, por para pak kohe është nënshkruar një Marrëveshje dhe shuma e kërkuar nga kjo shoqatë është zbritur, sepse në shumën prej 3 mijë €, do të përfshihen edhe shpenzimet e rrymës, ujit dhe naftës. Çdo kërkesë tjetër që do ta bënë kjo shoqatë do t’ i drejtohet kryetarit të Komunës, kurse si pikë ne vendosëm që në këtë seancë të hiqet nga rendi i ditës, sepse kanë qenë dy marrëveshje të cilat i kanë bërë me ish kryetarin e Komunës dhe këtë të cilën e kanë bërë tash, kanë qenë në kundërshtim kërkesat e asaj shoqata. Tash është arrit një pajtim dhe besoj se edhe ju do ta përkrahni dhe kjo kërkesë do të gjejë mirëkuptim në mesin tuaj.

Përkritazi me këtë pikë në debat morën pjesë një numër i madh i anëtarëve të Kuvendit, por pasi që kishte mospajtime dhe kundërshtime, kryesuesja propozoi që kjo pikë e rendit të punës mos të aprovohet në këtë seancë, por të shtyhet për ndonjë seancë të radhës, atëherë kur të bëhet një specifikim më detal i kërkesës së Shoqatës “Liria”. Të thuhet mirë sa mjete po i kërkojnë, sa shpenzime do të bëhen, për çfarë destinimi po kërkohen ato mjete, të bëhet një mbikëqyrje nga Kuvendi, mandej të sillet në KK me material të kompletuar dhe si të tillë e aprovojmë.

Në fund kryesuesja kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për atë që kjo pikë e rendit të punës të shtyhet për seancë të radhës:

Nuk aprovohet, por shtyhet për seancën e radhës pika 3 e rendit të punës: Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” në Gjilan, me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

5. Subvencionimi i normës së Interesit për kreditë e biznesit mikro dhe agro

Ismail Jonuzi – unë po sqaroj se ky është një projekt i cili për herë të parë po realizohet në Kosovë dhe si proces nuk ka qenë i lehtë. Komuna nuk është spozoruese e kredisë, bankat japin kredi, sepse bankat e kanë këtë të drejtë për të dhënë kredi me normë të interesit. Mirëpo ne po konkurrojmë për ta subvencionuar vetëm shkallën e interesit. Bankat e marrin rrishtun e vlerës së kredisë, kurse Komuna e merr si rrisht vetëm pjesën e interesit. Sipas një parallogarie nëse banka i jep 1 milion €, Komuna për tri vite i rrezikon 150 mijë €, do të thotë 50 mijë € për çdo vit. Banka i ka disa kritere për mikro- biznese

të vogla, për partner të ndryshëm, për agro biznesin. Mirëpo përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik do të shkojë lista e të gjitha bizneseve. Nuk mund banka t' i jep kredi asnjë biznesi për pa i shkuar lista nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik. Ne garantojmë vetëm për pjesën e interesit dhe kjo po ndodh për herë të parë, por shpresojmë se kjo iniciativë do të jetë e suksesshme.

Jehonë Hyseni- me kërkesë të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në takimin e mbajtur në janar të vitit 2015, ky komitet ka shqyrtuar çështjen e normës së interesit për kreditë e bizneseve mikro dhe agro dhe kjo iniciativë nga anëtarët e Komitetit për Zhvillim Ekonomik është vlerësuar si iniciativë shumë e dobishme për zhvillim të bizneseve lokale. Me këtë propozim bizneset lokale do të kenë mbështetje nga institucionet komunale, sepse do t' i epen mundësi më të mira bizneseve dhe më të lehta për zhvillim ekonomik. Në Komitetin për Zhvillim Ekonomik pas debateve të shumta është miratuar me shumicë të votave dhe është rekomanduar në KPF. Në këtë Kuvend kërkojmë që t' i jepni mbështetje këtij propozimi për t' i hap rrugë zhvillimit ekonomik lokal. Unë si kryesuese e këtij komiteti në emër të grupit kuvendar të LDK-së e mbështesim këtë projekt dhe besoj se do të gjej mirëkuptim edhe nga anëtarët e Kuvendit.

Nevzad Rushiti- së pari një përshëndetje për drejtorin i cili e ka sjell një propozim të mirë, sepse për mua një iniciativë e tillë është e qëlluar, por edhe kryesuesen e komiteti e falënderojmë për informatën. Në bazë të këtyre shifrave që unë po i vërej, drejtoria më e mirë e ka mundësinë për të përfituar dhe 1 milion € janë të cilat janë të mirë se ardhura për Komunën e Gjilanit dhe bizneset. Mirëpo duhet ta dimë se si bëhet përzgjedhja e bizneseve dhe duhet ditur se këtë a e bën Komuna apo së bashku në marrëveshje banka dhe Komuna? Ne jemi dëshmitar se bizneset në Gjilan nuk janë në gjendje të mirë në aspektin financiar, sepse i kanë borxhe shtetit, bankave, prandaj unë e kam një kërkesë që mundësisht që në këto raste të zgjidhet një përfaqësues i komisionit nga drejtoria që mundësisht t' u ndihmohet atyre që kanë nevojë. Kjo iniciativë është jashtëzakonisht e mirë, sepse interesi bankar është mjaft i madh në Kosovë, prandaj ky propozim- vendim besoj se do të ketë përkrahje nga të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Fehmi Sylejmani – unë gjithmonë jam ithtar i reformave dhe ideve kreative dhe në këtë rast e përkrahi idenë e drejtorit për Zhvillim Ekonomik, por kam një dilemë? Në material te kolona e fundit ku thuhet: "shuma e kredisë % vjetore e interesit": kërkoj që të informohem se sa është përqindja dhe kush e përcakton këtë përqindje? Banka apo kush? Nëse në këtë rast përqindja është e madhe, atëherë Komuna është humbëse, kurse më së tepërmi fiton banka. Unë e kam këtë dilemë, prandaj z. drejtor nëse ka mundësi të ma jep një sqarim?

Ismet Hajdini - më vejnë shumë mirë së pari që ne jemi Komuna e parë që po startojmë me këtë projekt i cili është projekt shumë i qëlluar dhe është në interes të qytetarëve, sidomos atyre që kanë projekte për biznese të vogla. Për këso biznese kanë qenë kamatat e larta të bankave, kurse me këtë propozim ne bizneseve po ia bëjmë një lehtësim shumë të madh, prandaj edhe është një mundësi për t' u rrit edhe numri i të punësuarve në këto tri vite të ardhshme në Komunën tonë.

Shukrie Rapuca- subvencionimi i normës së interesit për mikro dhe agro- bizneset si ide kjo ka qarkulluar prej shumë vitesh dhe në shikim të parë të duket atraktive, kur dihet se normat e kamatës për kredi bankare janë shumë të larta. Mirëpo kur merren parasysh premtimet që janë dhënë gjatë fushatës dhe kjo që veproni në këtë moment vetëm për një vit është diçka shumë e çuditshme!? Keni premtuar se do të hiqen të gjitha taksat për biznese, por ju i keni kthyer edhe taksat të cilat i ka hequr qeverisja e kaluar. Ju tash e keni sjell vendimin tjetër shumë interesant: Komuna do t' i subvencionojë normat e interesit për mirko- bizneset. Kjo do të thotë se Komuna nga njëra anë i ngarkon bizneset me taksa, kurse në anën tjetër premtim se do t' i ndihmojë me subvencione. Në Komunën tonë janë aktive mbi 3500 biznese, kryesisht të vogla dhe të mesme dhe nëse merret parasysh mesatarja e taksës prej 200 €, atëherë Komuna do t' i ngarkojë bizneset e veta me mbi 700 mijë €. Të arsyetohet kjo se po ndihmohen bizneset, për mua është diçka shumë e çuditshme ! Nëse ne dhe ju i harrojmë premtimet, unë jam e sigurt se bizneset nuk i

kanë harruar dhe nuk i besojnë! Nëse dëshironi t' i ndihmoni bizneset ia ndalni taksat bizneseve, sepse taksat janë plotësisht të paarsyeshme. Shtrohet pyetje pse bizneset duhet paguar taksë Komunës? Ne duhet ta punësojnë një të papunë në armatën e madhe të papunëve në Komunë?

Arben Mehmeti- diskutimi i fundit i koleges sonë është më tepër diskutim politik, por unë e kuptoj se ky është roli i opozitës, sepse unë kam qenë në atë pozicion dhe jam i vetëdijshëm se nganjëherë edhe duhet të epen deklaratime të tilla.

Kjo si ide duhet të çmohet jashtëzakonisht shumë, por është edhe një model i mirë i cili ka mundësi të jetë edhe model i mirë edhe për komunat e Kosovës. Është mirë që kjo ide ka filluar për herë të parë me Gjilanin dhe për këtë ide, këtë projekt para Kuvendit, duhet t' i falënderohemi drejtorit për Zhvillim Ekonomik, sepse ne si qeverisje jemi mësuar të shohim këso projekte, por ky projekt është i mirë se ardhur, sepse është rast ideal për t' i ndihmuar bizneseve. Mirëpo nëse funksionimin e bizneseve e shohim në taksa, kjo është gabim, sepse taksat janë obligime shtetërore dhe nuk qëndron ajo se ne po shpikim diçka si kuvendar. Mirëpo edhe vendosja e taksave është normale dhe nuk qëndron ajo që e tha zonja Rapuca, sepse ne kemi një vazhdim një kontinuitet sa i përket taksave.

Ky propozim është para neve është për t' i lavdëruar dhe për t' u mbështetur, sepse kjo është një lloj ndihme e madhe që iu epet këtyre bizneseve dhe nuk ka asnjë arsyeje tjetër për t' u ndal këto procese.

Ne duhet të krenohemi me këso modele që është shembull edhe për Kosovë. E kemi filluar me modelin e shpërndarjes së certifikatave në këtë vit (në këtë qeverisje), e që është një risi e që më vonë është bërë standard në tërë Kosovën. Ne jemi dëshmitar se mbi 20 komuna e kanë marrë modelin që ka filluar nga Administrata e Gjilanit. Tash është ideja apo modeli tjetër të cilin ne duhet ta përkrahim, por i cili model mund t' i shërbejë edhe komunave tjera në Kosovë.

Shukrie Rapuca- parafolësi e tha se diskutimi im ishte politik, por unë përmenda shifra dhe në shifra më pak ka politikë, sepse t' ia marrësh bizneseve 700 mijë € dhe në anën tjetër të propozohet vendim për t' ndihmuar në vlerë prej 100 mijë € gjatë tri viteve, kjo është pikërisht politikë.

Nevzad Rushiti- sa i përket taksave nuk është ashtu si po thuhet në Kuvend, sepse KK i ka ngarkuar vetëm bizneset e mëdha, kurse bizneset e vogla nuk janë taksuar fare. Është edhe një fakt se bizneset e mëdha në Komunë të Gjilanit nuk i dihet pronari dhe nuk dihet se kush e udhëheq atë biznes. Taksa për këto biznese është vjetore dhe nuk është mujore, prandaj nuk duhet bërë shumë polemikë përkitazi me taksat, sepse nuk kemi bërë asgjë të jashtëligjshme dhe nuk kemi prekur në xhepat e bizneseve.

Isa Agushi- unë e përgëzoj drejtorin për këtë projekt, sepse është një projekt shumë i qëlluar dhe mjaft i mirë dhe është projekt i cili po realizohet për herë të parë. Bankat të cilat operojnë në Kosovë, nuk kanë kamata, por kanë fajde, por subvencionimi i këtyre bizneseve të vogla e të mëdha është modest nga ana e drejtorisë, është pak, por e qëlluar. Sa i përket taksave të cilat u aprovuan në seancën e kaluar, unë kam qenë për t' i zbrit së paku për 50%, mirëpo ata të cilat po merren prapë po iu kthehen qytetarëve.

Shukrie Rapuca-ky është model i ri dhe ne po pajtohemi, por unë e bëra një krahasim për ta parë se sa po iu ndihmohet me këtë modelin e ri dhe thash se sa pak parë iu është ndihmuar bizneseve? A ndihmohen bizneset duke ia marrë 700 mijë € në vit, sepse mesatarja është 200 € për çdo biznes. Disa paguajnë më shumë disa më pak, por mesatarja është 200€, kurse totali është 700 mijë €, prandaj t' i thuash bizneseve se po iu ndihmojë, në fund të fjalës sime paraprake e thash se ne nuk mund t' i mashtrojmë bizneset në këtë mënyrë, sepse ata e kuptojnë këtë lojë. Ju mund të deklaroni se po i ndihmoni bizneset, por ata nuk e besojnë, sepse secili kupton diçka kur themelon biznes.

Krenare Latifi- ne si LVV, jemi për zhvillim ekonomik, jemi për subvencionim, por nuk jemi të interesuar që bizneset t' i fusim në borxhe vetëm për shkak të interesit i cili i paguhet nga Komuna.

Po ashtu kemi vërejtur se bëhet fjalë për bizneset mikro dhe agro dhe se duhet pasur kujdes sa i përket vlerave të mëdha mbi 10 mijë € dhe siç e thash edhe më lartë se bizneset mikro hyjnë në kategori, apo veprimtaria zejtare, ku duhet pasur kujdes që këto biznese mos të thellohen në borxhe. Ne jemi të interesuar për zhvillim ekonomik, por nuk ka mundësi të ketë zhvillim ekonomik në një të ardhme shumë të afërt, pra nuk mund të kemi zhvillim të hovshëm. Edhe ne si lëvizje përkrahim subvencionimin në parim, por duhet komiteti apo komisioni për zhvillim ekonomik ta rishikojnë edhe njëherë çështjen e vlerave të kredisë, por gjithashtu të sqarojë se si bëhet seleksionimi i bizneseve për marrje të kredisë?

Sahit Abazi- një mirënjohje për Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik për një propozim të vlefshëm, por duhet theksuar se ky është propozimi apo hapi i parë i kësaj drejtorie për një vit qeverisje. Ky është propozimi i parë serioz, sepse deri më tash nuk kemi pasur asnjë projekt, por kësaj radhe sa i përket këtij propozimi, normalisht se i kam dy propozime për drejtorin: e para që ky proces të monitorohet nga një trup e Komunës e KK-së. Të jetë pra një Komision nga KK i përbërë nga të gjitha partitë politike i cili do t' i monitorojë proceset e bankës e cila do të i krediton bizneset. Gjithashtu duhet ta monitorojë edhe procesin e ndarjes së përfituesve të cilët do të marrin kredi.

Unë nuk e thash që ky komision i KK-së të përcaktojë fitues, por vetëm ta monitorojë procesin.

E dyta është që të hiqet komplet pjesa e ku thuhet mikro bizneset dhe agrobizneset dhe unë propozoj që të jetë vetëm agro- bizneset, sepse në këtë mënyrë e krijojmë një qëndrueshmëri më të madhe të zhvillimit ekonomik nëse i japim mjete vetëm bizneseve prodhuese. Duke i dhënë mjete vetëm bizneseve prodhues, ata do të kenë mund të krijojnë kushte për t' i punësuar nga 2 -3 punëtorë, kurse te veprimtaritë shërbyese është më problem, sepse veprimtarit kryesisht i kanë mallrat e importuara dhe në këtë mënyrë ne po i ndihmojmë diku që po importon.

Selami Xhemajli- edhe në seancën paraprake, por edhe në mbledhjen e fundit të KPF-së është debatuar për këtë projekt, prandaj edhe unë në emër të grupit të AAK-së e mbështeti këtë pilot-projekt për subvencionim të normës së interesit për kreditë për bizneset e vogla dhe agro- bizneset. Mirëpo edhe unë kam kërkuar që drejtori të na jep sqarime për mënyrën e përzgjedhjes së bizneseve, gjegjësisht roli i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në këtë rast. Këtu bëhet fjalë edhe për mjete të Komunës, prandaj jemi të interesuar për ta parë mënyrën e menaxhimit të këtyre mjeteve. Nuk ishte i keq edhe propozimi për monitorim të përzgjedhjes së bankës, mirëpo pyetja e ime ishte se a ka hartuar kritere Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për mënyrën e zgjedhjes së përfituesve nga ky subvencion se cilat biznese të vogla do të përfitojnë, kurse për agro –bizneset jam në dakord që përmes Drejtorisë së Bujqësisë të bëhet zgjedhja e agro-biznesve. Unë jam për atë që bizneset e vogla të favorizohen ato që janë veprimtari prodhuese, por duhet të jetë e qartë se çfarë kritere ka përpiluar drejtoria në mënyrë që ato biznese të përfitojnë. Unë nuk jam për atë që vetëm banka t' i zgjedh përfituesit, por duhet të kenë qasje edhe drejtoria, por edhe Kuvendi ta formojë një komision të posaçëm për monitorim e procesit të procedurave se cilat biznese do të përfitojnë.

Jehonë Hyseni- pasi më është përmend emri më parë nga kolegja, por ky projekt ka mbështetje nga institucionet komunale dhe bizneset e vogla do ta kenë mundësinë më të lehtë për t' i zhvilluar ekonomikisht dhe kjo është shumë e mirë për bizneset agro dhe mikro bizneset.

Riad Rashiti- edhe unë parimisht e përkrahi plotësisht këtë propozim – ide të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik edhe pse në shikim të parë duket se është një projekt i cili e financon projektin e bankës, sepse qysh në qeverisjen e kaluar ka qenë një ide e tillë dhe kam qenë i kritikuar nga kolegët e mi se gjëja po bëj projekt për financim të bankës. Realisht unë e përkrahi këtë projekt, sepse ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik lokal dhe në krijimin e vendeve të punës. Mirëpo këtij propozimi i mungojnë disa tregues ekonomik, prandaj kishte qenë mirë të na informoni sa biznese do të përfitojnë nga ky projekt në fazë të parë, dytë dhe të tretë. Mirëpo duhet ta dimë edhe shumën e interesit sa është planifikuar t' i paguani biznesit është 500 apo 700 €. ? Është mirë që këto informacione të na i epni sot, por besoj se

janë kalkuluar ato të dhëna, por edhe nuk e kam të qartë se a është planifikuar shuma prej 50 mijë € për vitin 2015? Në bazë të cilit kod buxhetor do të bëhet ky financim, kur e dimë se ky projekt nuk është paraparë në buxhetin e këtij viti, prandaj është mirë këtë informacion të na jepni sot? Po ashtu te kategoritë e bizneseve për të cilat pat propozime se përfituese duhet të jenë vetëm agro-bizneset prodhuese do të thotë të bujqësisë si pemëtari, perimtari etj.

Sa i përket përzgjedhjes së bizneseve, unë pajtohem që të ketë një monitorim të cilin mund ta bëjë drejtorja, por unë mendoj që pak mund të ketë ndikime, sepse banka nuk hyn në rrezik në këtë kredi me rekomandime politike, sepse ajo e bartë rrezikun dhe nuk duhet pasur shumë shqetësime rreth kësaj dileme. Mirëpo unë po i kthehem edhe diskutimeve të tjera, sepse u përmenden edhe taksat, por unë nuk dua të hap debat dhe replika, por për një çështje iu lus shumë që mos e mohoni një gjë e ajo është rikthimin e taksave ! Mos e mohoni që ka pasur kategorizim të taksave, ka pasur kategorizim, ka pasur rikthim të taksave as nuk po them 700 mijë €, por as 100 mijë €, por ka pasur rikthim të taksave, sepse më 2013 taksat janë hequr te të gjitha bizneset, kanë pasur taksa vetëm bizneset të cilat kanë shtrirje nacionale dhe nuk ka pasur taks as “ Drini” Market, as “Luli”, as të tjerat. Nuk kanë pasur taks pompas e benzinës, nuk kanë pasur restorantet, nuk kanë pasur qebaporet, bizneset prodhuese. Të gjitha këto tash janë kthyer, por ne iu lusim që vetëm mos ta mohoni një diçka që ka ndodhur!?

Arben Maliqi- edhe unë po e jap mendimin tim për këtë pilot-projekt për të cilin duhet ta përshtesim drejtorin e Zhvillimit Ekonomik dhe kjo është një rast edhe për drejtorët e tjerë të cilët kanë ide dhe të cilët duhet të mendojnë për qytetarët. Duhet ta kemi me dije se mikro-bizneset nuk janë prekë, ato të cilat kanë sipërfaqe të vogël ato nuk janë prek, por ato që kanë lokale hoteliere, pompas e benzinës, kazinot e bastoret , e kanë shumë lirë taksën. Unë mendoj se te taksat kemi qenë shumë racional, është ruajtur ai kontinuiteti i cili ka qenë edhe më parë, por ndoshta diku edhe është prekur, mirëpo sido që të jetë mos të bëjmë këso lojëra, sepse sistemi i taksave është ashtu si i ka hije një vendi.

Valentina Bunjaku- Rexhepi – unë nuk e kam të qartë pse po debatohet për taksa, kurse nuk është në rend të punës. Ne deri më tash biseduam për pikën e rendit të punës, kurse tash në fund filloi debati për taksat. Ju lutem mos të dalim jashtë rendit të punës.

Riad Rashiti- Arben Maliqi është mirë për të na dhënë sqarime për edukatë fizike se si duhet bërë salltën dhe jo për çështje ekonomike. Unë e thash në fillim se nuk po dua të bëj debat, por e ngrita si çështje se ka pasur rikthim të taksave, duke iu lutur që mos ta mohoni, kurse Arbeni tash po mohon! Arbeni po thotë se mikro-bizneset nuk kanë taksë, pse po mohohet kjo ? Nëse sipas Arbenit qebaportja nuk është mikro-biznes, autolarja, nuk është mikro-biznes atëherë unë nuk po kuptoj asgjë që e kam kryer ekonominë?

Arben Maliqi- unë nuk hyj me një kallëp me Riadin, sepse ai nuk është i kategorisë sime, por unë i përmenda se mikro-bizneset që ekzistojnë, vëllai im e ka një lokal, por nuk pagan taksë. Ka shumë mikro-biznese në bazë të hapësirës që janë bërë dhe është mjaft mirë e specifikuar askush nuk pagan taksë. Mirëpo Riadi ka dëshirë t’i ngatërrojë gjërat, por ne jemi mësuar, kurse ai të vazhdojë në mënyrën e tij.

Ismail Jonuzi- mënyra e debatit nuk po më pëlqen, sepse së pari po flasin 20 anëtarë të Kuvendit, kurse në fund duhet ta merr fjalën drejtori. Ky është diskriminim për drejtorët, por ju vazhdoni me këtë mënyrë të punës. Sa i përket zonjës Rapuca, sot e kuptova që vjen nga sfera e ekonomisë. Me këtë po vërtetohet se ekonomia është në këtë shkallë, kur ajo i numëron 3500 biznese. Ku u mor vlera 200 €, në çfarë mënyre të doli vlerë 700 mijë €. Është mirë të mos manipulohet dhe mos të dezinformohen qytetarët.

Sa për informim të saktë që nga pas lufta janë të regjistruara 9470 biznese. Të gjitha ato që janë thënë nga zonja janë të pavërteta dhe nga të gjitha vetëm një është e vërtetë se Komuna edhe subvencionon edhe ngarkon me taksa, kjo është e vërtetë. Me të gjitha tjerat e keni dezinformuar opinionin.

Për këto 9470 biznese unë kam kërkuar që të bëhen analiza, regjistrim faktik në terren për ta vërtetuar sa kemi biznese aktive. Unë nuk e di nuk ia jap vetes atë të drejtë, por Riadi ka qenë më parë drejtor dhe nëse e di numrin e saktë është mirë ta thonë. Ne mund të themi se janë 2500 apo 3000, mund të spekulojmë, por numër të saktë nuk dimë. Nuk i dimë ndarjet dhe për ata që nuk i dinë kategoritë e ndërmarrjeve, mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha të lexojnë dhe ta kuptojnë.

Si koncept mirko dhe agro- biznese e kanë shërbimin e vetë dhe sa për informim mikro janë shitoret e ndryshme, janë prodhuesit e ndryshëm, por ne kufizime nuk mund të bëjmë, sepse nuk jemi ne ata që e kufizojmë. Ne e kemi dhënë një subvencionim për biznese që kanë 1 -5 punëtorë dhe qëllimi është që të bëhen biznese familjare. Sa i përket përqindjeve edhe për anëtarët e tjerë të Kuvendit, kriteret i përcakton banka, kurse ne do të konkurrojmë pas aprovimit në Kuvend, pastaj e përgatisim lëndën për ta shpallur tenderin. I kemi ndarë kategoritë në agro, sepse agro e kanë një shkallë më të lartë shkallën e interesit, kurse bizneset tjera e kanë shkallën më të ulët.

Riskun nuk e merr drejtorja as Kuvendi, risku është 50 mijë € në vit. Vlera e kredisë varet sa është shkalla e interesit, nëse është më e ulët mund të shkojmë në 1.5 milion dhe varësisht çfarë norme interesi na japin bankat, atëherë përcaktohet edhe vlera. Numri i saktë nuk mund të dihet, riskun e marrin bankat dhe kjo është sikur kur të merret një huazim.

U tha nga dikush se qenka projekti i parë, por nuk është projekti i parë, sepse panairi i cili ka qenë në Gjilan ka qenë një ndër panairët ndër më të mirat që është bërë e që e keni thënë edhe vetë, por e keni harruar. Panairi i dytë ka qenë më i vogël, sepse ka qenë i bletarisë.

Investimet kapitale i keni kërkuar, por adresimi i kërkesave nuk është i qartë, sepse çdo drejtori i ka investimet kapitale të ndara veç e veç.

Normat e interesit i caktojnë bankat. Ju e politizuat vetë këtë çështje me taksa dhe nuk është vërtetë se i kemi kthyer taksat, sepse unë po e marrë krahasimin me 2014 me 2015.

Shukrie Rapuca- z. drejtori është pjesë e ekzekutivit, kurse thotë se unë po bëj politikë! Politika është përvojë, sepse tash jam në mandatin e tretë si anëtare Kuvendit. Nëse e ke mbajtur mend si ide kjo ka qarkulluar prej shumë vitesh edhe në mandatin tonë dhe fillimisht duket atraktive, kur dihet se normat e kamatave për kredi bankare në Kosovë janë tepër të larta. Mirëpo kur merren parasysh premtimet që i keni dhënë gjatë fushatës dhe kjo që po veproni vetëm pas një viti me të vërtetë është e çuditshme.

Të gjitha taksat është thënë se do të hiqen, por edhe i kemi heq në qeverisjen tonë, kjo është e vërtetë dhe të gjithë e dinë këtë. Është shumë e vërtetë se janë regjistruar 9470 biznese, por aktive janë afër 3500. Unë i kam marrë informatat e kam vizituar qendrën dhe mesatarja e këtyre taksave është 200 € në muaj dhe në bazë të kësaj po i bie se ju i grumbulloni 700 mijë € në vit nga biznesmenët. Unë bëj politikë, bënë politikë edhe drejtori dhe të gjithë, por biznesmenët këtë e kuptojnë më së miri, sepse drejtori është në post politik, kurse bizneset nuk janë. Këtë unë e thash dhe asgjë dhe konsideroj se kjo është e mirë, është për ta përshëndetur, sepse dhe një pikë ujë në deti është i dobishëm (këto 150 mijë) € që po ia epni biznese, por 700 mijë € po ia merrni. Kjo është punë e përfunduar, kurse sa kam përvojë dihet, sepse jam anëtare e Kuvendit në mandatin e tretë.

Riad Rashiti-po krijohen pasaktësi të panevojshme, sepse ne e përkrahëm këtë propozim të gjithë dhe përsëri e përkrahim si propozim si projekt. Ne i kërkuam disa informacione dhe kërkuam përgjigje nga drejtori. Sa biznese do të përfitojnë nga ky projekt, sa është shuma e mjeteve që do të përkrahet një biznes, sa do të jetë interesi që duhet paguar bankës, sa do të ketë efekt në krijimin e vendeve të punës? Këto ishin ato që ne i kërkuam si informacione?

Sa për njoftim po e sqaroj se deri sa unë kam qenë drejtor i kësaj drejtorie e kemi pas identifikuar numrin e saktë të bizneseve në Komunë të Gjilanit. Ato shënime janë në Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe në Qendrën për Regjistrim të Bizneseve dhe besoj se ata e kanë plotësuar këtë fazë të shënimeve me këto të dhëna, sepse ka qenë desh të përfundohen këto të dhëna. Në atë kohë kur ne e kemi lënë qeverisjen kanë qenë afër 3 mijë e 300 biznese aktive në Komunë të Gjilanit, kurse kanë qenë të regjistruara 9 mijë, por disa janë shuar nuk janë aktive, kurse 3 mijë e 300 janë funksionale.

Në fund nuk po mund ta pranoj një konstatim të drejtorit, sepse ai po e bënë krahasimin 2014 me atë të 2015 dhe mendoj se ka të drejtë, sepse krahasimi 2014 me 2015 është një ndryshim i vogël, por unë po thirrrem në krahasimin në mes vitit 2013 dhe 2014 kur ka ndërruar qeverisja në Komunën e Gjilanit. Ku është dallimi dhe iu falënderoj.

Ismail Jonuzi-mirë që pranoj në fund Riadi se krahasimi është për vitin 2013 dhe atë ka qenë deshtë ta thotë para një viti. Me këtë po shihet se taksat nuk i kemi kthyer këtë vit, sepse nëse qenkan kthyer, kjo paska ndodhur para një viti. Nuk kemi kthyer taksa, nuk janë ngarkuar të hyrat nga taksat dhe nuk janë as 100 mijë € në vit. Ndërsa ato 700 mijë €, nuk e di se ku i keni shpikur dhe nuk është e mirë për juve kjo pasaktësi të thuhet në Kuvend.

Sa biznese fitojnë, nuk mund të dihet, por nëse të gjitha i fitojnë nga 10 mijë €, bëjnë 100 mijë €. Mirëpo kjo varet se kush përfiton, me çfarë shume aplikon, prandaj nuk është e mundur për ta ditur ne numrin dhe për atë ne e kemi caktuar vetëm vlerën e normës së interesit. Nuk do të thotë se do të harxhohen 50 mijë € në vit, sepse nëse nuk plotësohen bizneset dhe nuk plotësohen kriteret, atëherë mund të jetë edhe 20 mijë apo 30 mijë. Do të thotë që limiti më i lartë është 50 mijë €.

Sa i përket projekteve tjera është një projekt që e kemi fituar vitin e kaluar për efikasitet të energjisë elektrike në vlerë prej 1 milion €. Mirëpo besoj se brenda muajit besoj se vjen edhe një projekt tjetër (një kredi 20 vjeçare për 7 milion € për infrastrukturë e të cilat projekte jemi duke i zhvilluar negociatat. Koncepti i zhvillimit ekonomik nuk është politikë ditore, sepse koncepti i ekonomisë është puna, ka procedura dhe duhet angazhim. Për angazhimin tonë jam në gjendje për ta paraqitur tërë aktivitetin e drejtorisë, kur të doni unë i paraqes projeksionet dhe të gjitha aktivitetet e drejtorisë, por edhe të cilat do të paraqiten edhe në raport të vitit 2014.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet pika 5 e rendit të punës?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës: Subvencionimi i normës së Interesit për kreditë e biznesit mikro dhe agro, me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

Pas përfundimit të pikës së pestë të rendit të punës, në ora 13.30 anëtarët e Kuvendit shkojnë në një pauzë deri në ora 14.30

6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00167-8, me sipërfaqe prej 233 m², ZK-Gjilan

Sali Fazliu- përkitazi me këtë pikë sqarimet i dha zyrtari për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, z. Sali Fazliu të cilin sqarim, anëtarët e Kuvendit e kanë në materialet e tyre për seancë.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- për të dhënë sqarime për këtë rast ka qenë desh të jetë i pranishëm drejtori, por kjo të jetë hera e fundit që drejtorët kur kanë raste të tilla, patjetër duhet të jenë në seancë, sepse ata vetë thirren në ligjshmëri, ndërsa vetë nuk e respektojnë ligjin. Kjo lëndë është kthyer njëherë prapa, prandaj për shkaqe humanitare po vazhdojmë me debat.

Arben Mehmeti- unë e kam një pyetje për zyrtarin i cili e sqaroi këtë kërkesë. Nga ajo që e kemi këtu (vendimin), po shihet se nuk është i bazuar në asnjë ligj i cili ka të bëjë me shfrytëzimin e pronave, por është edhe ligji për LVV. Unë po e pyes Salihun se a ka ndonjë ligj apo udhëzim administrativ që e rregullon çështjen e dhënies së pronave në shfrytëzim, pronave komunale? Kërkesa ime është që të më open sqarime se a ka ndonjë ligj që e rregullon këtë aspekt?

Arijetë Rexhepi- rastet e ngjashme sociale pa dyshim se duhet të ndihmohen dhe nuk duhet së paku të humbim kohë. Mirëpo kërkoj për ta ditur se a e kemi vetëm këtë rast social i cili është pa kulm mbi kokë e për të cilin po bëjmë zgjidhje sot? Pas këtij rasti, unë mendoj se do të kemi shumë kërkesa të tilla si raste sociale dhe shëndetësore e të cilat do të kërkojnë që t'iu epen pronat në shfrytëzim. Mirëpo Komuna nuk do të ketë mundësi të ndajë troje për të gjithë të pastrehët. Po thuhet se po bëjmë përpjekje për të bërë zgjedhje për të gjitha rastet sociale e që janë 127 familje në Komunën tonë, por në këtë rast po bëjmë zgjidhje vetëm për një familje. Ne mendojmë se më mirë do të ishte zgjidhja e banimit të kësaj familje, pagesa e një qiraje deri në zgjidhjen e problemi kur të ndërtohet një objekt për banim kolektiv, siç është paraparë më herët destinimi i kësaj prone për këtë familje për të cilën po flasim. Në këtë mënyrë mund ta zgjidhim problemin e shumë familje të cilat jetojnë pa kulm mbi kokë dhe janë në gjendje të rëndë sociale. Destinimi është ndërruar nga pamundësia financiare nga qeverisja e kaluar dhe ka qenë shumë i gabuar ndërrimi i destinimit. Me rastin e grumbullimit të mjeteve të organizuar nga Komuna e Gjilanit dhe me vazhdim të mëtejme të aksioneve të tilla, por edhe me mjete të Komunës mund të ndërtohen banesa për këto familje.

Shfrytëzimi i pronave është i rregulluar me ligj dhe me Rregulloren e Komiteti për Pronë Kadastër është e paraparë që të zbatohen masat për ruajtjen dhe kthimin e pronës. Në rastet tona kur epet në shfrytëzim prona, apo iu ka caktuar qiraja për banim, a është e cekur ndonjë kërkesë nga Komuna apo e përcjell ndokush në rast se ka mundësi që të përparojë në aspektin ekonomik, a duhet të kthehet prona e Komunës, por edhe Komuna e paguan qiranë, por që ndoshta ka familje të cilat ndoshta janë në gjendje ta bëjnë vetë.

Ismet Hajdini- unë e kam vetëm një pyetje; nëse aprovohet ky propozim, personi a ka ndonjë dhurues për ta ndërtuar shtëpinë dhe a është dhuruesi i sigurt?

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 6 e rendit të punës

Aprovohet pika 6 e rendit të punës: Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00167-8, me sipërfaqe prej 233 m², ZK-Gjilan, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

7. Informatë rreth ndërtimeve pa leje në Komunë

Valentinë Bunjaku –Rexhepi –përkitazi me këtë pikë, neve si anëtarë të Kuvendit na është dërguar një raport i shkurtër me shkrim, deri në kohën kur e ka marrë detyrën me shumë përgjegjësi z. Veliu. Unë po e hapi debatin për këtë informatë, por paraprakisht po i kaloj fjalën z. Isa Veliu.

Isa Veliu- z. Veliu e dhe një informatë para anëtarëve të Kuvendit, por informata ishte dorëzuar me shkrim në materialet e seancës.

Nevzad Isufi- paraprakisht po e kuptoj që për u.d të Inspeksionit ka qenë një obligim i vështirë, sepse dihet se është ngarkuar para disa ditëve ose javësh me këtë detyrë dhe ndoshta ka qenë deshtë vetëm ta paraqes vetëm atë që është bërë paraprakisht. Do të ishte mirë që në Kuvend t'iu marrim gjërat pak më seriozisht dhe mos të mendohet se kush e ka fjalën do të bëhet ndonjë sulm apo mbrojtje, sepse kur flasim për institucionet tona, për drejtoritë tona po flasim me qëllim që të metat t'iu përmirësojmë dhe të bëjmë ndonjë zgjidhje më të mirë se sa që kemi bërë deri më tash.

Unë e pash raportin dhe nga vetë volumi dhe faqe sa ka raport, nëse i heqim tabelat të cilat t'iu marrin gjysmë faqe, nuk është asnjë faqe tekst për punën e një drejtorie siç është Inspeksioni për një punë njëvjeçare. Ne e dimë se as në Raportin nëntë mujor nuk është përfshirë puna e Inspeksionit dhe e dini se me shumicë në këtë Kuvend e kemi aprovuar vendimin që Drejtoria e Inspeksionit është hequr, kurse inspektorët janë shpërndarë nëpër drejtori të caktuara, kurse në anën tjetër këtu na vije si titull Drejtoria

e Inspeksionit. Ne nuk e dimë se cilit vendim t' i besojmë? Vendimit të mëparshëm kur ka ekzistuar inspeksioni, apo vendimin që e ka marrë Kuvendi që inspeksioni si drejtori nuk funksionon?

Deri më tash nuk kemi marrë asnjë ankesë nga kjo Drejtori, së paku ne nuk jemi njoftuar që ka pasur ankesa për mungesë të numrit të inspektorëve. Në raport thuhet se janë vetëm tre inspektorë që janë të pamjaftueshëm. Nga mandati i qeverisjes po ashtu është thënë se ka munguar operatori i cili merret me rrënimin e objekteve pa leje dhe kjo është thënë në një nga seancat e para të vitit të cilin e lamë pas dhe është thënë se është hapur konkursi apo tenderi për një operator të tillë. Mirëpo deri më sot nuk është bërë një zgjedhje e tillë dhe nuk kemi përsëri operator për rrënimë pa leje dhe thuhet për shkaqe teknike. Këto shkaqe teknike nuk janë të njohura as për neve, por as për qytetarët.

Ne si grup i LVV me kohë kemi reaguar që në seancat e para për mospunën e kësaj drejtorie, sidomos në lëmin e ndërtimeve, por kemi reaguar dhe me rastin e riorganizimit të sajë duke dhënë arsye të pabazuara për mos ekzistimin e sajë. Nga ky raport shumë i shkurtër dhe i mangët del se nuk është punuar mjaft. Në anën tjetër në këtë Kuvend është marrë vendim për shpërbërje të kësaj drejtorie, apo siç e quani ju riorganizim të sajë, por në anën tjetër është emëruar një drejtor i Inspeksionit, por ne nuk kemi informacion se ai është shkarkuar apo ndërruar? Drejtori nuk është shkarkuar, kurse në anën tjetër e kemi një ushtrues të ri të detyrës së drejtorit e që ai është z. Isa Veliu. Në këtë mënyrë është vazhduar dhe me DKRS-në, sepse edhe për këtë drejtori thuhet ushtrues detyrës dhe kemi riorganizim dhe ne nuk jemi njoftuar me riorganizimin që është bërë në këtë drejtori.

Në bazë të asaj që është thënë në raport të Inspeksionit del se është punuar shumë pak, sepse tregojnë vetë shifrat. Inspeksioni prej tre inspektorëve e të cilat nuk paskan kryeshef i paskan inspektuar 166 objekte për një vit. Nëse për 12 muaj, nëse llogarisim se një muaj i ka pasur 3 javë ose 21 ditë pune i bie që për 252 ditë tre inspektorët brenda një dite e kanë inspektuar një objekt e gjysmë, apo për secilin nga një gjysmë objekti. Nëse kjo nuk qëndron dëshiroj që të më demantojnë edhe anëtarët e tjerë dhe ekonomistët dhe mos të ma zënë për të madhe, sepse këto janë shifrat.

Ne e kemi shtruar çështjen e ndërtimeve pa leje edhe në seancat e tjera, mandej njëra nga këto mbetet edhe më tutje pa përgjigje. Në këtë informatë thuhet se janë bërë 106 procesverbale dhe po kaq vendime për ndërprerje pune. Mirëpo në fakt asnjë nga këto vendime nuk janë respektuar, por as ato 56 aktvendime për rrënim. Vetëm këto të dhëna janë të mjaftueshme për të parë sa është punuar dhe si është punuar?

Të nderuar anëtarë të Kuvendit qyteti ynë është në kaos të përgjithshëm sa i përket ndërtimeve dhe gjendja është kthyer në atë gjendjen e pasluftës të vitit 2000, atëherë kur nuk kishim funksionale shumicën e institucioneve tona. Mirëpo edhe tash pas kaq viteve e kemi përsëri këtë gjendje e cila nuk di si mund të quhet? Me një fjalë ndërtimet pa leje janë bërë, vazhdojnë të ngritën ndërtime pa leje edhe tash në pikun e ditës. Megjithatë se shumica e këtyre objekteve janë pa leje dhe për pa i respektuar planet urbanistike dhe është vetëm një numër i vogël që kanë marrë leje e të cilët ndoshta numërohen me gishta të një dore. Duhet të bëjmë dallime në mes të një ndërtimi individual pa leje dhe një ndërtuesi individual shtëpi banimi dhe një ndërtuesi i cili ndërton objekte kolektive? Padrejtësia më e madhe iu ka bërë qytetarëve të cilët i kanë përfillur ligjet, kriteret, janë pajisur me leje dhe kanë paguar leje për ndërtim, sepse ato po del se janë pakicë, kurse këta që kanë ndërtuar pa leje janë përfituesit më të mëdhenj. Me ardhjen në fuqi të Ligjit për legalizim po del se kushdo që ka ndërtuar me një procedurë shumë të shkurtër mund ta legalizojë ndërtimin e tij i cili ndërtim nuk i ka respektuar planet urbanistike, por ka ndërtime ndoshta ku janë paraparë rrugë dhe objekte tjera publike e që e prish dukshëm planin dhe rregullimin hapësinor të qytetit duke shëmtuar edhe pamjen dhe normat standarde të qytetit. Në bazë të kësaj qytetarët më të ndërgjegjshëm po dëmtohen dukshëm, kurse ata që nuk kanë përfill asgjë në këtë rast i bie se kanë të drejtë! Ne atyre po i themi se nuk është asgjë, ne vetë i kemi mbyllur sytë për ndërtimet pa leje. Kemi kërkuar që kjo pikë të shqyrtohet para dy muajve, por ju e keni shtyrë deri tash dhe me këtë ndërtuesve i keni thënë vazhdoni, sepse ne nuk e kemi ndërmend të merremi me këtë çështje. Ne e dimë që numri i ndërtimeve pa leje është shumë i madh, por me vetë faktin se tash ka filluar legalizimi i këtyre ndërtimeve në bazë të një kërkesë për një afat të caktuar deri më 5 shkurt dhe e dimë që ka arrit numri mbi 2 mijë kërkesa për legalizim e që nënkupton se këto 2 mijë ndërtime janë pa leje më së paku. Mirëpo procedura e tillë ende nuk ka përfunduar e që do të thotë se mund të dyfishohen,

trëfishohen ose katërfishohen etj. Duhet ta dini se një pjesë e qytetarëve asnjëherë nuk bënë kërkesë për legalizim, sepse ata nuk e kanë ndërmend të bëjnë biznes me shtëpitë e tyre, i kanë ndërtuar shtëpitë pa leje, vazhdojnë t' i shfrytëzojnë ato dhe nuk i japin llogari askujt. Po ashtu e dimë që qyteti ynë së paku që disa vjet ka bërë revidime të planeve dhe i ka ndryshuar ato dukshëm dhe të gjithë kanë menduar se është bërë një punë e mirë. Mandej për këto revidime të planeve janë dhënë para mjaft voluminoze, por nëse këto revidime brenda një periudhe nuk janë respektuar, nënkupton se këto plane brenda një periudhe duhet të revidohen edhe njëherë dhe përsëri të japim para për revidime dhe për t' i arnuar ato projekte. Ky proces është plotësisht i gabuar. Po ashtu të legalizimet është thënë se do të pranohen objektet ndërtuara ose do të legalizohen objektet të cilat janë ndërtuar deri në 30 shtator 2013. Unë nuk e di që ndonjë institucion iu ka dhënë qytetarëve ndonjë informatë ose ka kërkuar nga ata dhe t' i thotë se brenda kësaj periudhe ose merrni leje ose kjo periudhë nuk iu njihet juve as si ndërtues legal as si ndërtues ilegal. Kam pyetje; si është vendosur që data 30 shtator 2013 të jetë fundi i njohjes së ndërtimeve të cilat mund të paraqiten si të legalizuara? Shtrohet pyetja se çka do të ndodh me këta njerëz që nga 30 shtatori deri në këtë periudhë kanë ndërtuar objekte, sepse këta as nuk hyjnë në kuadër të këtyre që i legalizojnë dhe as nuk hyjnë në kuadër të atyre që iu pranohen ndërtimet. Pra paraprakisht për një periudhë 3, 4 apo 5 muaj është deshtë që me kohë t' i tërhiqet vërejtja qytetarëve, por kjo nuk është bërë nga ana e juve. Në këtë Kuvend është shtruar edhe çështje e pompës së benzinës "Hip Petroll", por të gjithë keni heshtur dhe sot e kësaj dite ky biznesmen nuk e ka përfillur asgjë dhe as nuk ka leje dhe as nuk ka pëlqim. Gjithashtu edhe ndërtimet të Fabrika e Bukës po ndërtohen po ashtu dhe pjesa dërmuese janë pa leje dhe pa pëlqim. Kur këto objekte lejohen që të ndërtohen në këtë mënyrë, nuk mund të flitet as për kritere as për zbatim të ligjeve të ndërtimit. I tillë është objekti i cili është ndërtuar afër Gjimnazit i cili objekt ka marrë leje, por ajo leje nuk ka qenë deshtë të epet, sepse ai objekt nuk i plotëson kushtet duke i llogaritur hapësirën që duhet ta ketë për rreth dhe duke i llogaritur edhe ndërtimet që i ka afër. Këso shembuj mund të gjejmë sa të dëshironi, sepse kemi raste ku në pjesë të qytetit janë ndërtuar lagje të tëra dhe për 15 vjet këto nuk janë trajtuar. Mandej nuk është bërë ndonjë kufizim dhe t' i thuhet qytetarëve se një pjesë duhet të lihet për rrugë dhe infrastrukturë tjetër dhe mos të krijohet një kaos e që herët e apo vonë patjetër do të merremi me këto raste. Kur ne do të dalim me këmbëngulje në mbrojtjes të pronës publike dhe deri kur do të ndërtohet vend e pa vend, për pa përfillur asnjë normë as të ndërtimit as të planeve rregullative as urbanistike të qytetit. Mendoj se këto janë çështje serioze dhe është dashur të gjithë ne para se gjithash, ekzekutivit në përgjithësi, kryetarit në veçanti mos t' i lehet puna vetëm një drejtori të caktuar apo inspektori të caktuar, por si institucione duhet të veprojmë sipas ligjit, sepse ne po i japim shembull të keq qytetarëve duke iu thënë që ju që e përfillni ligjin, ju që i përfillni rregulloret e keni "gabim"!!?

Unë shembuj këtillë mund t' i jap sa të doni, por nëse flasim për shtëpitë e vogla individuale, sepse unë fola në përgjithësi për disa gjëra të cilat bien ndesh me të gjitha ligjet dhe normat ligjore. E dimë se edhe Qeveria e kaluar e ka dhënë shembullin më të keq siç është ai i Kadastrit i cili po ashtu nuk i ka përfillur kriteret e ndërtimit dhe ne jemi shembull i keq për qytetarët, kurse nga ata në forma të ndryshme varësisht sa është i fuqishëm ekonomikisht apo në forma tjera bëjmë presion, apo nuk bëjmë fare. Ju faleminderit për durim!

Riad Rashiti- ka disa muaj që ne kemi kërkuar si grup kuvendar i PDK-së që të diskutohet për këtë gjendje alarmante të ndërtimeve pa leje në Komunë të Gjilanit. Mirëpo edhe në këtë seancë po shihet serioziteti apo jo serioziteti për ta shqyrtuar këtë problematikë për ne si opozitë dhe për qytetarët.

Vetë mungesa e drejtorit të DUMM këtu tregon edhe një ikje institucionale nga përgjegjësia, sepse Drejtoria e Inspeksionit është shuar dhe është bartë në këtë Drejtori të Urbanizmit. Drejtoria e Urbanizmit dhe ajo e Inspeksionit e ka përgjegjësinë për ta mbikëqyrur dhe monitoruar planet rregulluese urbanistike të cilat janë hartuar viteve të fundit në Komunën e Gjilanit. Ne sot e kemi këtu u.d të Inspeksionit i cili na e ka dërguar një informatë e cila informatë tregon një jo seriozitet dhe një formalitet sa për sy e faqe të kësaj teme të cilën ne kemi kërkuar për ta diskutuar.

Në këtë raport janë dhënë disa karakteristika të cilat qëndrojnë apo nuk qëndrojnë për të cilin nuk dua të debatoj, mirëpo në këtë raport qëndrojnë shumë të pavërteta dhe unë vetëm një po e përmendi.

Thuhet se përveç të tjerave Komuna ka pasur kompani të kontraktuar për rrënimin e objekteve pa leje¹. Unë vetëm një gjë e di dhe po i drejtohem të gjithëve, kur në vitin e kaluar kur është ndryshuar qeverisja është thënë pas muajit shkurt kur të përmirësohet koha, Inspeksioni do të fillojë me aksione, por kaloi shkurti edhe bora e parë dhe e dytë e tretë dhe po ven muaji tjetër shkurt dhe nuk ndodhi asgjë!

Gjithashtu e dimë, nëse nuk gaboj është kontraktuar, me 29 korrik është dhënë tenderi në Komunë të Gjilanit dhe nuk qëndron ajo arsyeshmëria dhe konstatimi i u.d se nuk ka kompani të rrënimit për objekte pa leje. Me 29 korrik iu është dhënë tenderi një kompanie nga Kaçaniku për rrënim të objekteve pa leje me emrin “Murseli Kompani” me një vlerë të planifikuar afër 40 mijë €. Kjo është dhënë në tender, por pse nuk është realizuar është çështje e biznesit që dikush po e stopon këtë aksion në Gjilan. Po mundohem që mos t’i përsëris fjalët dhe vërejtjet që i përmendi kolegu nga LVV, por në qytet dhe hyrje të Gjilanit është bërë një arenë e ndërtimeve pa leje. Ne e dimë që edhe në qeverisjen e PDK-së ka pasur ndërtime pa leje, por edhe para neve ka pasur ndërtime pa leje, mirëpo duhet bërë krahasime se ka pasur më shumë apo më pak ndërtime të tilla. Mirëpo ne së paku në qeverisjen e kaluar kemi pasur një seriozitet dhe një angazhim për t’i parandaluar dhe zvogëluar numrin e objekteve të ndërtuara pa leje dhe mendoj se me sukses ia kemi arrit këtij qëllimi. Sot jo që nuk ka kontroll, por ndërtimet pa leje janë shndërruar në një arenë që kush ku të dëshiron, kur të dëshirojë ndërton pa leje dhe askush nuk i pengon. Arsyet janë të ndryshme pse po ndodh kjo? Gjithashtu është shqetësuese se kush po qëndron prapa këtyre investimeve? Pse nuk po ndërmerret asnjë hap për një vit për ta ndaluar këtë dukuri? Ne kemi kërkuar përgjigje, por asnjë veprim nuk është bërë në këtë drejtim¹. Një shqetësim tjetër është edhe e atyre e ndërtimeve në vendet ku po ndodhin? Nëse i analizoni në bazë të disa fotove që unë i kam këtu ku shihen ndërtimet ku kanë ndodhur dhe çfarë efekte kanë dhënë ato në zhvillim ekonomik. Te Fabrika e Bukës, në hapësirën e së cilës janë dy objekte pa leje, por edhe nuk dihet se kush qëndron prapa këtyre investimeve, kush janë këta investitorë, pse nuk po pengohen, pse po investojnë kompanitë jabanxhi në Gjilan? Shumica e investitorëve vijnë nga Prishtina, sepse atje është ndaluar anarkia në Prishtinë, kurse në Gjilan ka ndryshuar niveli, por ka ndryshuar për të keq, sepse ata investitorë kanë ardhur në Gjilan dhe ata njerëz janë deputetë, ministra dhe ish ministra e që vijnë këtu dhe ndërtojnë në fabrikat të cilat kanë qenë të punësuar me mijëra punëtorë e të cilat tash janë privatizuar dhe ato sot kanë falimentuar. Në këtë mënyrë ka ndodhur me Fabrikën e Tekstilit, është “Çeliku”, prandaj kërkoj nga u.d që të jep një përgjigje për ndërtimet pa leje të cilat zgjasin me muaj dhe vit dhe asnjëherë nuk ndalen, kërkoj përgjigje si është e mundur dhe pse ndodh kjo? Rasti i Çelikut është mjaft i qartë, sepse ai ka aplikuar në muajin prill dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje, kurse objekti ka përfunduar!

Ne kërkojmë për ta ditur, pse DUMM nuk është përgjigj, qoftë pozitivisht, qoftë negativisht, apo ndoshta po pritet që të finalizohet objekti pastaj të epet përgjigja! Po ashtu te Fabrika e Bukës ne iu kemi drejtuar, Urbanizmit dhe drejtori (Valoni), është përgjigj zyrtarisht në kërkesën tonë dhe ka konstatuar se këta investitorë nuk janë pajisur me leje ndërtimi dhe se të njëjtit nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë për t’u pajisur me leje ndërtimore. Kjo është përgjigje zyrtare e drejtorit të Urbanizmit. Mirëpo shtrohet pyetja pse drejtori i Urbanizmit nuk ka marrë veprim tjetër?

Po ashtu ndërtimi tjetër te Fabrika e Duhanit ku kanë filluar rrënimet e depos së asaj ndërmarrje dhe po bëhet përgatitja për të filluar ndërtimet edhe aty dhe po ndodh një shëmti në qytet, sepse fabrikat po shndërrohen në objekte kolektive banimi dhe afariste. Kjo është një dukuri e juaja, por nëse kthehemi në retrospektivë në vitet 2006, 2007 dhe pak më herët edhe sot janë shumë objekte pa leje, prandaj iu bëj pyetje juve si qeverisje aktuale, çka keni ndërmarrë që keni lejuar të ndërtohet objekti gjigant i cili është te lagjja e Spitalit me të cilin rast me qindra familje janë dëmtuar duke paguar banesa dhe ato kurrë nuk janë funksionalizuar. Ky është ai mentaliteti qeverisës që lejon ndërtime, pa kontroll, pa leje, pa siguri të tyre dhe dështon investitori, dështon blerësi dhe dështon secili që merr pjesë në këtë sektorë.

Gjithashtu është edhe ndërtesa te “Dheu i Bardhë” ku janë ndërtuar dy objekte kolektive pa leje ndërtimore dhe pa mbikëqyrje. Gjithashtu edhe në “Dardani” është një objekt i tillë, por edhe investimet e tjera që kanë filluar dhe kanë mbet, kemi tejkalime që kanë ndodhur dhe janë shndërruar në një biznes për pushtetin e të cilat paraqesin një dukuri shumë të shëmtuar për Komunën e Gjilanit, sepse janë duke u shkatërruar të gjitha investimet që janë bërë për rregullimin e planeve urbanistike për të pasur një qytet

modernë ashtu siç i ka hije qytetit. Unë e di që kritikën tona mund të quhen të pabaza, por unë mbaj përgjegjësi për këtë diskutim, por në këtë biznes po qëndrojnë njerëz të pushtetit. Unë institucionalisht për këtë e fajtoj kryetarin e Komunës, kryesuesen e Kuvendit, drejtorët aktual, Inspeksionin dhe Urbanizmin si institucione dhe si individ, sepse mos veprimi i tyre tregon se ose janë pjesëmarrës në këtë biznes ose janë të papërgjegjshëm, jo institucional dhe jo përgjegjës për pozitat ku i drejtojnë institucionet përgjegjëse. Vetë fakti që është tenderuar një kompani “Jabanxhi” siç thotë kryetari për rrënim të objekteve nga Kaçaniku po shihet se jabanxhiu, me jabanxhinë po merren vesh dhe po i kryejnë punët pa pengesa. Investitori është jabanxhi, kompania për rrënimë është jabanxhi dhe Gjilani është shndërruar në anarki!

E kam një pyetje edhe për u.d të Inspeksionit: sa raste janë paraqitur dhe sa raste penale janë ngritur nga Prokuroria e Shtetit, kryesisht për inspektorët komunal të Gjilanit?

Gjithashtu kemi kërkuar qysh moti listën e objekteve pa leje të cilat janë identifikuar gjatë vitit 2014.

Ne e posedojmë një listë me 55 objekte dhe sigurisht se është rritur ky numër, sepse edhe sot ndërtimet vazhdojnë dhe arsyeja e mos përgjigjes po tregon se ikja e kryetarit të Komunës dhe mos pjesëmarrja e tij në seancë është një shenjë se ai po ik nga përgjegjësia. Kjo dukuri është tepër shëmtuese, sepse ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në buxhetin e Komunës, sepse sikur këto objekte të ishin pajisur me leje ndërtimore sigurisht se së paku 200 mijë €, ishin të hyra (më 2014). Ju faleminderit për durim.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ju faleminderit z. Rashiti, por ju e patë se drejtori i DUMM ishte që nga fillimi këtu, mirëpo iu deshtë të shkojë, sepse kishte takim me ministrinë përkatëse. Ai nuk ka pse të ik, sepse përsëri do të jetë këtu.

Isa Agushi- unë nuk e pata ndërmend të flas, por ato që po i dëgjoj sot janë alarmante dhe me të vërtetë po e ndiej veten keq si pjesë e pozitës. Pajtohem me opozitën nëse janë të vërteta këto gjëra! Unë nuk jam pjesë e kësaj qeverisje në qoftë se ka keqpërdorime. Unë vetë distancohem si person dhe me të vërtetë po befasohem se si ka mundësi një kompani nga Kaçaniku ta fitojë tenderin për rrënim të objekteve pa leje? A është e vërtetë nuk e di, por pyetje po i bëj u.d të drejtorit? Ky raport që është sjell këtu, nuk është raport ky është vetëm sa për të thënë që kemi bërë diçka. Unë kërkoj dhe propozoj që mundësisht që u.d i drejtorit ta sjellin një raport në seancën e radhës, më të kompletuar, më të detajuar për ta pasur të qartë se çka ka ndodhur në Komunën tonë. Sipas kësaj që u tha, gjërat janë alarmante dhe në qoftë se qëndrojnë këto gjëra si po thotë opozita, duhet urgjentisht të bëhet një ndërhyrje e organeve kompetente, sepse kjo është shqetësuese për Komunën tonë.

Avdyl Aliu- vetë fakti që informata, jo raporti ka ardhur nga Drejtoria e Inspeksionit, po garantoj se nuk ka ardhur gabimisht, sepse Drejtoria e Inspeksionit ende ekziston, ende nuk është bërë shpërndarja e inspektorëve dhe për atë arsyeje u.d është Isa Veliu. A e dinë dikush apo jo se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Urbanizmit dhe të Inspeksionit, por unë po e sqaroj se këto janë shumë të ndara. DUMM i përpunon kërkesat për leje ndërtimore dhe kur e pranon kërkesën duhet ta trajtojë deri në përgjigje të fundit. Pas kësaj DUMM nuk është më përgjegjës se a ndërton dikush me leje apo pa leje? Tash vije kapitulli tjetër është puna e Inspeksionit për ndërtimet pa leje. Mua më kujtohet shumë mirë që në informatën e parë sipas të gjitha gjasave për 100 ditëshin, kur e ka dhënë Drejtoria e Inspeksionit ka pasur krahasime dhe ka qenë një situatë shumë e mirë në aspektin e ndërtimeve në Komunën e Gjilanit.

Edhe si qeveri Komunale, por edhe si familje ose biznes, nuk do të thotë që qëllimet realizohen 100%, por diku do të jetë ndonjë defekt. Inspeksioni na ka dalë dobësi dhe janë parë ato dobësi dhe është krijuar një vakum i padëshirueshëm dhe kjo është gjendja që e kemi. Nuk po tentoj për ta arsyetuar askënd, por po e them se ne e kemi trashëguar një gjendje shumë të rëndë në aspektin e ndërtimeve pa leje. Kjo nuk ka ndodhur tash, por e kemi trashëguar këtë gjendje dhe në të kaluarën e kemi trashëguar gjendjen pa një kompani për rrënim të objekteve pa leje. Sa i përket Kualitetit (Fabrikës së Bukës), ka qenë e privatizuar me një spinof të thjeshtë dhe blerësi e ka pasur për obligim që dy vite mos ta ndërroj veprimtarinë të cilën

e ka pasur ajo fabrikë. Mirëpo pas dy vite është punë e blerësit se çka bën ai me atë pronë. Ai ato i ka përmbush dhe ende prodhon bukë do të thotë ato i ka tepër. Se çka bën dikush me pronën e vetë, është çështje e tij, sepse prona është e shenjtë. Aty ka ndërtime edhe me leje në pronë të Fabrikës së Bukës, por edhe pa leje dhe janë dy ndërtime pa leje!? Si janë ndërtimet me leje? Kjo është ai morali i dyfishtë, sepse aty lejet epen me vendimin e qeverisjes së kaluar. Në atë qeverisje është marrë vendimi për V+P +7 në qeverisje të kaluar, do të thotë bazë juridike është një vendim i qeverisjes së kaluar.

Ju e dini shumë mirë dhe përsëri po iu rikujtoj që në një seancë apo dy më herët, ne këtu e kemi marrë një vendim për ta punuar një Plan rregullues urbanistik "Qendra 4". Edhe këtë po iu them nëse nuk e dini se kemi marrë vendim për "Qendra 4" e kemi marrë për atë pjesën duke filluar nga ajo pjesa nga Xhamia e Vogël dhe komplet Kualitetin, Fitorja, Tekstili etj. Aty është duke u bërë një Plan rregullues dhe është duke u përgatitur një bazë edhe më e mirë. Ju faleminderit.

Fehmi Sylejmnai- u dhanë vërejte edhe nga dy përfaqësues të tjerë për Raportin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe nga kjo u vërejt se ka shumë mangësi dhe raporti duhet të jetë më i specifikuar dhe më përmbledhës dhe më i detajuar. Edhe unë propozoj dhe e përkrahu idenë e z. Agushi që në seancën e ardhshme edhe pse u tha më herët se Drejtoria e Inspeksionit dhe Urbanizmit janë të ndara, unë megjithatë mendoj se Urbanizmi dhe Sektori i Inspeksionit të ndërtimtarisë janë hallka të pandashme që duhet të kenë bashkëpunim të ngushtë, prandaj duhet ta përpilojnë një raport shumë më përmbledhës dhe përsëri në seancën e radhës të diskutojmë përsëri.

Shukrie Rapuca- sipas mendimit tim derisa opozita, por edhe përfaqësuese nga pozita e vlerësojnë gjendjen alarmante për shkak të ndërtimeve të egra është shumë e arsyeshme të vihet në rend të ditës edhe njëherë në seancën e ardhshme.

Ismet Hajdini- unë deshta ta jap i një kontribut dhe t' i jap disa njoftime, sepse unë për 4 vite rresht (një mandat) jam marrë me këtë problematikë, sepse kam qenë drejtor i Inspeksionit. Problemi i ndërtimeve pa leje nuk është problem vetëm i qytetit tonë, sepse këtë problem e kanë të gjitha qytetet në Kosovë. Duhet bërë një analizë shumë të thellë për t' i analizuar pse janë bërë ndërtime të mëdha pa leje.

Ne ende nuk po e dimë sa është numri i objekteve pa leje, po i shohim disa shifra, por ende nuk po e dimë numrin e saktë. Mirëpo unë lirisht mund t' iu them se në krahasim me qendrat tjera të Kosovës, lirisht mund t' iu them se Gjilani është në pozitë shumë, shumë më të mirë dhe kjo gjendje është në radhë të parë në sajë të qytetarëve të Gjilanit, sepse vetëdija qytetare në Komunën tonë është në një nivel më të lartë për t' u pajisur me leje ndërtimi. Kjo dokumentohet edhe me kërkesën për legalizim dhe jam i bindur se në Gjilan do të ketë numër më të vogël të kërkesave për legalizim në krahasim me qytetet e tjera, sepse leje ka më tepër. Në Gjilan deri para dy dite kanë qenë 2600 kërkesa për legalizim, kurse në Ferizaj janë mbi 10 mijë dhe arsyeja pse në Gjilan ka më pak kërkesa për legalizim është se leje të ndërtimit ka më tepër. Këtu u përmend edhe kompania e rrëtimeve, por edhe në periudhën e kaluar kemi pasur problem të madh me kompaninë e rrëtimeve dhe unë si drejtor kam pas kërkuar nga kryetari i Komunës që Komuna ta ketë një mekanizëm të vetin. Ne e kemi pasur një kompani të rrëtimeve, por ka pasur raste kur ajo kompani nuk ka ardhur kur e kemi caktuar ditën e rrëtimeve edhe pse ne i kemi ftuar edhe policinë, por kompania nuk ka ardhur. Mirëpo edhe tash kërkoj që Komuna të pajiset me mekanizmin e vetë të rrëtimeve i cili mekanizëm edhe Komunës do t' i kushtojë shumë më lirë, por ai mekanizëm do të hyjë në përdorim edhe te drejtoritë e tjera.

Problemi tjetër është (Planet rregulluese), sepse brenda 4 viteve KK i Gjilanit i ka aprovuar 7-8 plane rregulluese e që janë të domosdoshme për një Komunë ose qytet. Aty janë bërë lëshime me qindra hektarë, mirëpo askush prej anëtarëve të Kuvendit nuk ka bërë pyetje sa kushton zbatimi i një plani rregullues? Problemi i komunave në Kosovë është se nuk kemi mjete për zbatimin e atyre planeve, prandaj po na paraqiten probleme. Ne kemi pasur probleme në terren për zbatim të atyre planeve, sepse nuk kemi pasur mjete për ta bërë shpronësimin e atyre pronave. Ky nuk është problem i Komunës, por problem i Qeverisë, sepse Qeveria duhet ta ketë një buxhet për shpronësime. Unë sa e di Komuna e

Gjilanit i ka 500-600 mijë € për shpronësime e të cilat mjete nuk mjaftojnë as 2-3 %. Pengesa kryesore është mungesa e fondit për shpronësime për zbatim të planeve rregulluese, kurse problemi tjetër është se Drejtoria e Inspeksionit duhet ta ketë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Gjyqin. Ne kemi pasur raste që kemi shirituar objekt, pronari e ka larguar e cila është vepër penale, ne e kemi proceduar në gjykatë dhe asgjë nuk është ndërmarrë nga gjykata, kurse dënimi për këtë rast si vepër penale është deri në 5 vite burg. Për të mos u përsërit këto ndërtime pa leje, së pari duhet të plotësohet numri i inspektorëve në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, sepse aktualisht qenka vetëm një inspektor. Nga kjo po shihet se pa staf nuk mund të kryhen punët. E dyta sa i përket mekanizmit, Komuna urgjent duhet ta ketë, sepse nuk ka zgjidhje me kompani dhe kjo edhe në qytete tjera nuk ka qenë efikase. E treta kërkohet edhe një bashkëpunim shumë i ngushtë edhe në mes të drejtorive, sepse janë të ndërlidhura edhe Shërbimet Publike edhe Kadastri dhe Gjeodezia, mandej edhe policia dhe gjyqësori. Për pa qenë një rrjet i bashkëpunimit nuk mund të ketë suksese.

Arben Maliqi- unë fol për ndërtimet pa leje dhe këto qëndrojnë, sepse janë argumentet dhe e dimë se çka po ndodh dhe nuk është se po ndodh vetëm në këtë mandat, por ka ndodhur edhe përpara dhe do të ndodhin edhe një kohë, por ne është mirë që të angazhohemi maksimalisht që t' i anulojmë gradualisht këto dukuri. Mirëpo mua ajo që po më brengos më së shumt është ajo se po ndërtohet në tokat bujqësore dhe kjo për mua është alarmante. Sa i përket tokave bujqësore ne nuk kemi tokë të mjaftueshme dhe të ndërtohen edhe fabrikat, shtëpi dhe ndërtime të larta në toka bujqësore kjo është shumë alarmante. Në mjedis të arave ndërtohen shtëpi, por gjendje më e rëndë bëhet kur ndërtohen edhe lloj-lloj fabrike, pranë të cilave është plotë mbeturina dhe e dimë shumë mirë se çfarë është gjendja.

Është momenti i fundit që të mobilizohemi, sepse ky qytet nuk është as i opozitës dhe pozitës, por është i të gjithëve. Ne duhet ta gjejmë një gjuhë të përbashkët, sepse Drejtoria e Inspeksionit është shumë e ndjeshme, por në Prishtinë së pari është marrë vendim që toka bujqësore të shndërrohet në tokë ndërtimore. Kjo është më kryesorja dhe kjo duhet të ndodh edhe në qytetet e tjera. Unë ju lus edhe njëherë që të mundohemi maksimalisht dhe ta caktojmë se çka po vendoset por ato objekte pa leje, por ajo më me rëndësi është që tash e tutje mos të lejojmë. U përmend Fabrika e Bukës, por atë pronë atij personi ia ka dhënë shoqëria (AKM)-ja dhe ia ka dhënë me spinof për dy vjet, kurse ai tash mund të ndërtojë çka të dëshirojë. Kjo në të vërtetë është shumë keq, por faji nuk është te ne, mirëpo ne duhet që tash e tutje ta bëjmë zgjidhjen.

Selami Xhemajli- unë vetëm e kam një pyetje për u.d të drejtorit: në raportin njëvjeçar shihet se janë 56 shiritime të objekteve, por në katrorin tjetër janë 56 aktvendime për rrënime. Çka është ndërmarrë për këto objekte të cilat janë shirituar dhe për ato që kanë pasur aktvendime? A është proceduar më tutje për këto lëndë, sepse përgjegjësia penale është edhe për atë që ndërton pa leje dhe nuk aplikon për leje, mirëpo përgjegjësi penale është edhe për atë që është përgjegjës për ta kryer një punë, por nuk vepron. Çka është ndërmarrë ose nga ana e Inspeksionit, por edhe Prokuroria a ka marrë veprimet ndaj këtyre njerëzve nëse janë paditur nga Inspeksioni?

Isa Veliu-sa i përket numrit të inspektorëve të cilën pyetje e bëri z. Isufi, unë e kam bërë një krahasim me vitin paraprak në vitin 2013 kur kanë qenë 5 inspektorë të ndërtimit dhe një ekzekutues dhe plus ekspeditues. Këtë vit e kemi pasur numrin më të vogël, për shkak të shkuarjes së tyre në pozita të tjera. Numri i inxhinierëve është shumë i vogël në sektor të ndërtimit, sepse është sektor i ndjeshëm dhe shumë pak inxhinier janë të interesuar për të punuar në sektor të ndërtimit. Ne para dy vite i kemi pasur tri kolege inspektore dhe unë dua nuk ta minimizoj rolin e femrës në këtë aspekt, por megjithatë detyra e inspektorit sidomos të ndërtimit është specifike sa i përket kompanisë së rrënimeve ndoshta u keqkuptova, sepse unë nuk thash që nuk ka kompani të rrënimeve, sepse e kam parë se ekziston kompania e rrënimeve që nga 13 apo 17 gushtit "Murseli Kompani" me seli në Kaçanik. Mirëpo ajo kompani pagesën po e kërkonte me kuota dhe pagesa bëhet në bazë të asaj se çka punon dhe çmimet ishin

enorme. Ne një rrënim që e kemi pasur për një shtëpi në zonë jashtë banimit, vetëm ajo na ka kushtuar 6 mijë €.

Mirëpo këto shifra që ishin diku 56 (shiritimet e objekteve dhe aktvendimet për rrënim), këto janë të njëjta, sepse objekti edhe shiritohet dhe lëshohet vendimi për rrënim të objektit. Te këto raste numri mund të jetë më i vogël, sepse disa raste kanë qenë në proces të pajisjes me pëlqim urbanistik dhe me leje ndërtimi. Prej neve është kërkuar një informatë dhe ne e kemi sjell, por nuk është raport, sepse ne kemi pasur mundësi ta sjellim edhe një raport prej 10 faqeve dhe mund ta përshkruajmë në detale gjendjen. Në këtë informatë janë përfshirë të gjitha gjërat të cilat duhet dhënë.

Ndaj personave të cilëve iu ka shirituar objekti, por nuk e kanë ndal punën kemi paraqitur kallëzime penale, kurse të tjera janë në proces të marrjes së lejes së punës, kurse ato të cilat e kanë prish planin rregullues janë në evidencë për rrënim. Sa rastet e korrupsionit u bë pyetje ka, por unë nuk jam i thirrur për këto, sepse me këto merret Prokurori e Shtetit, kurse ne nuk jemi të informuar për këto gjëra.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- për z. Veliu e kam një pyetje konkrete; në rrugën e Varroshit është një objekt duke u ndërtuar, ju i keni vendos shiritat, por ai person po e vazhdon punën. Si ndalet ajo punë? Si ndalen punimet në atë objekt?

Isa Veliu- atij objekti iu ka lëshuar vendimi për rrënim dhe së shpejti pritet procedura për ta rrënuar, por edhe kallëzim penal është bërë në gjykatë. Për këtë objekt është kryer procedura dhe nuk ka nevojë edhe një herë të përsëritet.

Riad Rashiti- sa i përket rastit të Kualitetit është e vërtetë që ajo pjesë është privatizuar dhe blerësi mund të bëjë çka të dëshirojë me të dhe kjo krejt është në rregull. Mirëpo çështja është se aty po ndërtohet pa leje dhe ky është shqetësimi ynë, pse po lejohet të ndërtohet pa leje? Është e vërtetë se aty një objekt ka marrë leje pasi i ka ndërtuar 5 kate, kurse një objekt ka marrë leje, tjetri nuk ka marrë. Ne kemi hartuar plane rregulluese urbanistike dhe ato i kemi zbatuar dhe iu kemi përmbajtur aq sa kemi ditur.

Rasti i njëjtë është te Gjimnazi, sepse për tri vite, ai pronar nuk ka mundur ta fillojë ndërtimin, sepse ne ia kemi dhënë lejen, por në bazë të kriterëve dhe kushteve urbanistike, por ai nuk e ka filluar, sepse nuk i ka konvnuar ajo leje. Kur është bërë ndërrimi i pushtetit, ai është pajisur me leje, por me tjera kushte. Bëhet pyetja pse? Pse atëherë nuk e filloi objektin? Pse atëherë iu është dhënë leja me tjera kushte, kurse sot me tjera kushte? Tash ka plotë raste të tilla, por orientimi dhe qëllimi si institucione komunale si vullnet si orientim dhe angazhim i institucionit komunal po mungon gatishmëria për t' i parandaluar rastet, për t' i zvogëluar këto raste, për mos të ardhur deri te rrënimi, sepse më mirë është se të parandalohen rastet se sa të rrënohen objektet. Është mirë që të ndryshohet qasja në Komunë të Gjilanit ndaj kësaj problematike. U tha nga ud. Se më 2013 paskan qenë 5 inspektorë, kurse sot është një (1), prandaj kjo tregon angazhimin dhe seriozitetin se sa ka gatishmëri kjo qeverisje për ta parandaluar ndërtimin e egër.

Akti i shuarjes së Drejtorisë së Inspeksionit është edhe kjo një indikator që tregon, se dikujt po i konvenon për ta zbeh fuqinë, angazhimin dhe aktivitetin e kësaj drejtorie në Gjilan. Gjithashtu ka qenë desh së paku deklarativisht të prononcohet kryetari i Komunës duke i drejtuar qytetarëve që mos të investojnë me milion euro, sepse do të gjobiten dhe do të merren masa të tjera ligjore dhe të luten që mos të bëjnë ndërtime pa leje! Ky është një dyshim se persona të caktuar në qeverisjen komunale, qoftë në Kuvend, qoftë të lidhur me nivelin qendror, nuk po i përjashtoj edhe nga partia e ime dhe këtu ka ndikim jashtëzakonisht të madh politika e cila i ka fut hundët në qeverisjen komunale për ta hesht çdo veprim institucional dhe për t' i hesht këto dukuri negative. Ne bëjmë thirrje si KK me kërkesë shumë të qartë drejtorit të Urbanizmit që menjëherë të merr masa dhe të bëhet një paralajmërim serioz i cili do të kishte efekte dhe së paku përgjysmë do të ndalet kjo dukuri.

Shukrie Rapuca- të gjithë e kuptuam se në këtë aspekt gjendja është alarmante sa i përket ndërtimeve pa leje në Komunë të Gjilanit. Duhet theksuar se të gjithë së bashku, pozitë dhe opozitë duke e përfshirë edhe ud. e drejtorit e konstatuan se tash më gjendja është alarmante. Mesazhi te qytetarët po shkon se

nuk ka mekanizëm për të dal nga kjo situatë! Unë këtë e kuptova dhe besoj edhe për të tjerët ishte e qartë!

Leonorë Bunjaku- sa i përket planeve rregulluese është vërtetë se janë bërë mjaft plane me standarde evropiane në të cilat plane është paraparë, ujësjellësi, kanalizimi, telefonia nëntokësore dhe tërë infrastruktura e kompletuar. Unë e mora fjalën, sepse kam qenë edhe anëtarë e Komitetit të Urbanizmit në mandatin e kaluar, por më erdhi keq kur ish drejtori i Inspeksionit e tha se gjëja askush nuk qenka interesuar për zbatimin e atyre planeve. Mua më vjen keq, por besoni se nuk ka pasur asnjë anëtarë të Kuvendit dhe anëtarë të Komiteti që nuk ka qenë në pajtim se këto ishin disa plane të mrekullueshme, por është shtruar pyetje se kur do të bëhet zbatimi i këtyre planeve? Asnjëherë nuk është bërë ky implementim, sepse e njëjta përgjigje ka qenë se nuk ka buxhet për shpronësim. Mirëpo ne duhet shqyrtuar mundësinë se si mund ta bëjmë këtë zgjidhje? Është mirë që të vijnë investitorët nga jashtë, por dhe prej mërgatës, por kjo bëhet nëse ne i krijojmë kushte atyre për të investuar dhe t' i sigurojmë qëndrueshmëri dhe stabilitet. Ne duhet ta gjejmë një zgjidhje, që t' i implemtojmë ato plane, sepse nëse ato nuk zbatohen brenda 5 viteve, prapë do të vijë koha që të investojmë në hartim të planeve.

Unë mendoj se duhet t' i krijojmë kushte investitorëve që të vijnë në Kosovë, nëse ne nuk kemi mjete për zbatim të planeve rregulluese, etj.

Ismet Hajdini- me siguri zonja në Komitet ka pyetur, por unë e thash në Kuvend se kur ashtë aprovuar një plan rregullues, askush prej kuvendarëve nuk ka parashtruar pyetje se një plan rregullues sa e ka koston? E dyta nuk ka investitorë që vjen nga jashtë për të investuar në infrastrukturë, sepse investitori vjen për fitim personal, prandaj ai mund të vijë për ndonjë prodhim, kurse për infrastrukturë nuk ka në botë që vjen për të investuar në asfaltim, kanalizim, trotuar ose telefoni etj. Investitori e shikon interesin e tij personal dhe interesi i tij nuk është infrastruktura. Infrastrukturën duhet Komuna t' ia mundësoj çdo investitori. Për këtë është fajtor është vetëm Qeveria e cila nuk posedon me fond për shpronësime, prandaj komunat nuk mund të zhvillohen nëse nuk kanë fond të shpronësimeve.

Sadullah Kadriu- nuk dua t' i përsëris gjërat, por ndoshta do të kishte qenë mirë që të përpilohet një tekst që të mos mashtrohen njerëzit për investime, sepse do të rrënohen të gjitha objektet që do të ndërtohen pa leje? Ndoshta kjo do të ishte ndonjë metodë me të cilën ne mund t' i parandalojmë, por edhe duke e shtuar edhe efikasitetin e Drejtorisë së Inspeksionit. Gjithashtu Drejtoria e Inspeksionit dhe ajo Urbanizmit duhet të kenë bashkëpunim shumë të ngushtë, sepse vetëm këto dy drejtori mund ta ndalojnë ndërtimin e objekteve pa leje !

Valentinë Bunjkau –Rexhepi- unë propozoj që të dalim me një komunikatë të përbashkët përkitazi me ndërtimet pa leje, ne si KK, sepse ndoshta edhe një komunikatë e tillë do ta ketë efektin e vetë. Nëse nuk respektohet edhe kjo komunikatë, atëherë duhet të pasojnë rrënimet.

Me këto debate dhe vendime seanca i përfundoi punimet në ora 16.00

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi